

Instituti për Studime të Avancuara GAP

## Letërnjoftimi i Komunës së Kamenicës 2012

Korrik, 2012

***“Letërnjoftimi i Komunave”*** është projekt i Institutit GAP i cili vlerëson qeverisjen komunale dy vite pas zgjedhjeve lokale të 2009. Ky projekt është implementuar në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Huluntuese (BIRN) dhe Qendrën e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC). Rezultatet e hulumtimeve të GAP për qeverisjen komunale janë debatuar me kryetarët e komunave në emisionet “Jeta në Kosovë”. Debati në “Jeta në Kosovë” për Komunën e Kamenicës është transmetuar në RTK më 5 korrik 2012.

## Përmbajtja:

1. Shkurt për Kamenicën .....	3
2. Pesë problemet më të mëdha të identifikuar gjatë fushatës elektorale 2009 .....	4
2.1 Mungesa e investimeve në infrastrukturën e qytetit.....	4
2.2 Kanalizimi i ujërave të zeza .....	5
2.3 Mungesa e ujit të pijes dhe rrjetit të ujësjellësit.....	6
2.4 Prerja e paligjshme e pyjeve.....	7
2.5 Rregulli në administratë .....	7
3. Performanca buxhetore e komunës së Kamenicës.....	8
4. Shpenzimi i parasë publike .....	10
5. Ivestimet kapitale .....	17
6. Administrata komunale.....	21
6.1 Zyra e Kryetarit.....	22
6.2 Zyra e Prokurimit.....	23
6.3 Drejtoria e Administratës së Përgjithshme .....	24
6.4 Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor .....	28
6.5 Drejtoria e Inspektoratit.....	29
7. Rastet e ngritura pranë Gjykatës Komunale.....	29
8. Arsimi .....	30
9. Shëndetësia .....	32
10. Transparenca.....	33
11. Puna e Kuvendit Komunal të Kamenicës.....	34
12. Përmbushja e premtimeve të fushatës zgjedhore 2009 .....	36

## 1. Shkurt për Kamenicën

Kamenica jo zyrtarisht thirret edhe si “Komuna e Dardanës”. Shtrihet në pjesën më lindore të Kosovës. Me procesin e decentralizimit, pas zgjedhjeve lokale të 2009, një pjesë e territorit të Komunës së Kamenicës u shkëput me kur edhe u krijua komuna e re e Ranillugut, kurse tri fshatra tjera i u bashkëngjitën Komunës së Novobërdës. Territori dhe popullsia e shkëputur nga Komuna e Kamenicës ishin kryesisht vendbanime të banuara me qytetarë të komunitetit serb. Komuna e Kamenicës, edhe para decentralizimit edhe pas decentralizimit, është karakterizuar me një tolerancë të lartë të bashkëjetesës në mes komuniteteve.

Një paradoks i krijuar pas decentralizimit është ai i fshatit Petrovc. Pas decentralizimit, territori i Komunës së Kamenicës është ndarë në dysh, ku fshati Petrovc, edhe pse është në kuadër të Komunës së Kamenicës, nuk ka asnjë lidhje territoriale me Komunën e Kamenicës, por kufizohet me Komunën e Gjilanit dhe atë të Ranillugut. Banorët e këtij fshati praktikisht janë më të lidhur me Komunën e Gjilanit (arsimimi, trajtimi shëndetësor, aktiviteti ekonomik), kurse legalisht janë të lidhur me Komunën e Kamenicës (pagesa e taksave, regjistrimi i automjeteve, nxjerrja e dokumentacionit personal).

Pas regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, rezultatet preliminare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, del se Kamenica ka 35.600 banorë, 8.161 banesa dhe 6.184 ekonomi familjare. Vetëm 13 komuna tjera kanë më pak numër banorësh se sa Komuna e Kamenicës. 27.3% e banesave janë të pabanuara. 67.8% e familjeve në Komunën e Kamenicës kanë pesë e më shumë anëtarë.

Kamenicën e karakterizon po ashtu një numër i madh i familjeve të cilat kanë së paku një anëtar të familjes me banim dhe punësim jashtë vendit. Remitancat konsiderohen burim i konsiderueshëm i të ardhurave për shumë familje dhe ekonominë e komunës në përgjithësi.

Gjendja ekonomike dhe sociale në këtë komunë është në nivel jo të kënaqshëm. Në këtë komunë ekzistojnë rreth 1900 biznese, por të gjitha janë biznese të vogla dhe të mesme. Si komunë kufitare, pjesa më e madhe e territorit të së cilës kufizohet me territorin e Republikës së Serbisë, në territorin e kësaj komuna ushtrohet veprimtari e lartë e kontrabandës ndër-kufitare, sidomos kontrabanda e kafshëve të gjalla.

Që nga zgjedhjet e para lokale në 2000, Komuna e Kamenicës është qeverisur nga dy kryetarë komune. Për dy vite, 2008-2009, Komuna e Kamenicës është qeverisur nga PDK dhe Kryetari i Komunës z. Begzad Sinani. Kurse për tërë vitet tjera (2000-2007 dhe 2010-2013) komuna është qeverisur nga LDK dhe kryetari i saj z. Shaip Surdulli. Deri në fund të këtij mandati, Shaip Surdulli do t'i bëjë plot 11 vite në krye të udhëheqjes së Komunës së Kamenicës, çfarë e bën atë si personin i cili ka qëndruar më së gjati në postin e kryetarit të komunës, gjersa Komunën e Kamenicës e bën komunën e cila është qeverisur më së gjati nga një individ.

## **2. Pesë problemet më të mëdha të identifikuara gjatë fushatës elektorale 2009**

Gjatë fushatës elektorale të 2009, Instituti GAP kishte identifikuar pesë probleme kryesore<sup>1</sup> të cilat ishin ngritur si shqetësime gjatë kontakteve me qytetarë. Pesë problemet më të mëdha në fund të 2009 ishin:

1. Mungesa e investimeve në infrastrukturën e qytetit
2. Rrjeti i dobët kanalizimit dhe mungesa e tij në shumë pjesë të komunës
3. Mungesa e ujit të pijes dhe e rrjetit të ujësjellësit
4. Prerja e paligjshme e pyjeve
5. Rregulli në administratë.

Dy vite pas identifikimit të këtyre problemeve, Instituti GAP ka matur progresin që ka arritur komuna në tejkalimin e këtyre problemeve të cilat shqetësojnë banorët e kësaj komune:

### **2.1 Mungesa e investimeve në infrastrukturën e qytetit**

Për dallim nga vitet e mëparshme, në dy vitet e fundit ka pasur investime të shtuara në qytetin e Kamenicës. Komuna ka investuar në ndërtimin e dy rreth rrotullimeve në qytet, njëri afër tregut të qytetit dhe tjetri në rrugën e Rubovcit. Rrethrrrotullimet, përveç që kanë ndikuar në rritjen e sigurisë në komunikacion, ato kanë ndikuar edhe në përmirësimin e pamjes urbane.

Po ashtu është ndërtuar unaza e qytetit, përkaj lumit, e cila shtrihet nga Stacioni i Autobusëve e deri tek tregu. Ndërtimi i kësaj unaze ka bërë që automjetet e rënda, kamionët dhe autobusët, të shfrytëzojnë këtë rrugë dhe jo rrugën përmes qendrës së qytetit.

Është ndërtuar trotuari dhe është asfaltuar rruga përkaj shkollës së mesme në qytet. Është investuar në ndërtimin e ujësjellësit në lagjen Malësia. Si dhe janë asfaltuar pjesë të rrugëve më të vogla apo mbulim të gropave në rrugë të ndryshme të qytetit.

Me ndihmën financiare të Bankës Botërore, Komuna dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale kanë pastruar shtratin e lumit të qytetit. Është investuar edhe në gjelbërimin e hapësirave në qytet, mirëpo jo gjithëherë investimet në gjelbërim kanë qenë të suksesshme. Më 2010 Komuna ka mbjellur drunj të llojeve të ndryshme përkaj trotuarit nga ura e qytetit e deri në fshatin Berivojcë dhe ky investim është treguar me vend. Në vitin 2011 Komuna kishte investuar në gjelbërimin e

---

<sup>1</sup> Instituti GAP. Kamenica – raporti komunal. Tetor 2009. Burimi:  
[http://institutigap.org/repository/docs/Kamenica-raporti\\_komunal.pdf](http://institutigap.org/repository/docs/Kamenica-raporti_komunal.pdf)

hapësirave përskaaj rrugës kryesore të qytetit. Mirëpo mbjellja e luleve dhe barit kishte ndodhur në muajt e vonë të verës dhe i tërë investimi i komunës kishte shkuar kot, për shkak të planifikimit jo të duhur të investimit. Edhe këtë vit (2012) Komuna ka investuar në gjelbërimin e hapësirave përskaaj trotuarit në qendër të qytetit. Mbetet të shihet se si do të mirëmbahen këto hapësira gjatë ditëve të verës. Fontana dhe gjelbërimi i një pjesë afër Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, investim i bërë në mandatin e kaluar, nuk është mirëmbajtur asnjëherë.

Mirëpo, përkundër investimeve në infrastrukturën e qytetit, ende ekzistojnë probleme të shumta në infrastrukturën e qytetit. Rruga kryesore e qytetit, afër parkut, është e dëmtuar dhe kërkon riasfaltim. Në të njëjtën gjendje është një pjesë e madhe e rrugës "Iliria", si dhe rrugës nga rrethrotullimi në rrugën e Rubovcit e deri tek rruga që lidh lagjen "Çamëria".

## **2.2 Kanalizimi i ujërave të zeza**

Problem tjetër i cili ka shqetësuar qytetarët në vjeshtën e 2009 ka qenë edhe kundërmimi i ujërave të zeza dhe mungesa e rrjetit të kanalizimit.

Gjatë viteve 2010 dhe 2011 Komuna e Kamenicës ka investuar 165.805 Euro në rrjetin e kanalizimit, kurse më 2012 janë planifikuar të investohen edhe 45.000 Euro. Komuna ka investuar në rregullimin e sistemit të kanalizimeve në fshatrat Rubovc, Karaqevë e Epërme, Kopërnice, Berivojcë, si dhe ka financuar një pjesë të kanalizimit në lagjen e epërme në fshatin Koretin. Po ashtu, me ndihmën financiare të Bankës Botërore, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) ka pastruar shtratin e lumit në pjesën e qytetit.

Përkundër kësaj, problemi më i madh me ujërat e zeza nuk është evituar, e ai është derdhja e tyre në shtratin e lumit. Në mungesë të ujërave të rrjedhshme në lum, shtrati i lumit është shndërruar në shtrat të ujërave të zeza. Ujërat e zeza së bashku me bërllokun, kanë bërë që lumi të kundërmojë dhe me këtë problem përballen më së shumti banorët që jetojnë përskaaj lumit në fshatin Berivojcë, Koretin dhe Topanicë. Edhe pse banorët bartin një pjesë të fajit për shkak të derdhjes së mbeturinave, Komuna asnjëherë nuk u ka ofruar zgjidhje më të përshtatshme, qoftë duke u ofruar kontejnerë apo duke i penalizuar ata të cilët bëjnë derdhjen e mbeturinave në lum. Shumë kompani ndërtuese, bëjnë shkarkime masive të mbeturinave ndërtimore në shtratin e lumit.

Andaj nevojitet intervenimi i Komunës me qëllim të shmangies të ndonjë epidemie që mund të vije nga papastërtia në lum dhe nga kundërmimi i ujërave të zeza.

## 2.3 Mungesa e ujit të pijes dhe rrjetit të ujësjellësit

Një nga problemet me të cilët janë përballur një pjesë e madhe e banorëve të Komunës së Kamenicës në 2009 ka qenë edhe mungesa e ujit të pijes. Me këtë problem janë përballur një pjesë e madhe e banorëve të lagjeve të ndryshme të qytetit dhe disa fshatra që shtrihen në pjesët më të rrafshta të Komunës.

Në përgjithësi Komuna e Kamenicës në territorin e saj ka burime të bollshme të ujit të pijes dhe ujë kualitativ. Fshatrat në pjesën malore të komunës nuk e ndjehen problemin e ujit të pijes. Uji i Kikes, i cili shfrytëzohet në masë të madhe nga banorët e fshatit Hogosht por edhe nga banorët e fshatrave tjera, njihet për kualitetin e tij të lartë. Madje ky ujë shfrytëzohet edhe nga dy fabrikat e ujit të cilat biznesin e tyre e ushtrojnë në këtë komunë.

Për dy vite (2010-11) Komuna e Kamenicës ka ndarë 104.796 euro për rrjetin e ujësjellësit. 35.151 euro janë ndarë për shtimin e sasisë së ujit të pijshëm në qytet dhe në fshatin Karaqevë e Poshtme. Projekti për shtimin e kapacitetit të ujit të pijes në qytet është shtyrë edhe për vitin 2012. Përkundër ekzistimit të rrjetit të ujësjellësit në qendër të qytetit, burimet e ujit nuk janë të mjaftueshme për të furnizuar pa ndërprerë të gjithë konsumatorët. Përveç kësaj edhe gypat e ujësjellësit janë të vjetruar dhe nevojitet investim në ndërrimin e tyre.

Për ujësjellësin në lagjen “Malësia” janë ndarë 25.000 euro në 2011. Shpimet për burimet e ujit në këtë lagje ishin bërë që në mandatin e kaluar, mirëpo rrjeti i ujësjellësit nuk ishte funksionalizuar.

Po në 2011, Komuna ka ndarë 44.105 euro për ujësjellësit në Koretin dhe Petrovc. Ujësjellësi në Koretin ishte shtrirë që në 2009, mirëpo nuk ishte funksionalizuar. Në 2011 banorët e fshatit Koretin kishin mundësinë që të kyçen dhe të furnizohen me ujë nga ujësjellësi, mirëpo jo për kohë të gjatë. Komuna ende nuk e ka marrë nën menaxhim rrjetin e ujësjellësit në Koretin. Banorët janë kyçur individualisht në rrjet të ujësjellësit, pa ndonjë kontroll dhe pa orë për të matur sasinë e ujit të harxhuar. Si pasojë, banorët e kanë keqpërdorur ujin për të ujitur kulturat bujqësore. Në pamundësi për të matur sasinë e ujit të shpenzuar, edhe shpenzimet e rrymës e cila nevojitet për të mbajtur në funksion pompat e ujit nuk janë paguar, çfarë ka bërë që KEK-u të shkyç ujësjellësin nga rrjeti. Pas kësaj banorët janë mobilizuar për të gjetur zgjidhje të këtij problemi, duke u vetëorganizuar. Por Komuna edhe më tutje nuk ka bërë asgjë që rrjeti i ujësjellësit të menaxhohet zyrtarisht nga Komuna apo nga kompania rajonale e ujësjellësit “Hidromorava”. Kurse ende nuk kanë filluar punimet në ujësjellësin e fshatit Petrovc.

Shumë vite më parë është ndërtuar ujësjellësi në fshatin Topanicë, mirëpo edhe ky ujësjellës nuk është nën menaxhim të Komunës apo të kompanisë rajonale të ujësjellësit. Banorët e kyçur në rrjet paguajnë një shumë të vogël për shfrytëzimin e

ujit dhe këto mjete i grumbullon përgjegjësi i fshatit, i cili me mjetet e grumbulluar paguan rrymën e shpenzuar nga ujësjellësi dhe prishjet që mund të ndodhin.

Në projektet e 2012, komuna parasheh që të bashkë-financojë me qytetarët ujësjellësin në Roganë, Muqivërc dhe në Hodonoc, ku janë ndarë 96.048 euro.

## 2.4 Prerja e paligjshme e pyjeve

Pjesa më e madhe e territorit të Komunës së Kamenicës është e mbuluar me pyje. Krahas komunave të rajonit të Dukagjinit (Pejë, Deçan, Istog), Kamenica në 2009 përballej me problemin e shkatërrimit të pyjeve nga prerja ilegale e tyre.

Në mars 2010, ka hyrë në fuqi Ligji i ri për Pyjet<sup>2</sup>, i cili delegon kompetencat për mbrojtjen e pyjeve nga niveli qendror në atë lokal. Kjo masë ka ndikuar në rritjen e masave për mbrojtjen e pyjeve. Megjithatë mbrojtja e pyjeve mbetet ende një sfidë për Komunën e Kamenicës. Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe Drejtoria e Inspektionit, Policia e Kosovës dhe Agjencia e Pyjeve nuk janë treguar efikase në parandalimin e rasteve të prerjes ilegale të pyjeve. Përgjegjësit për mbrojtjen e pyjeve janë akuzuar nga vetë delegatët e partisë qeverisëse se po bashkëpunojnë me prerësit ilegal të pyjeve.<sup>3</sup> Për çdo vit Drejtoria e Bujqësisë lëshon mesatarisht 65 fletëparaqitje për kundërvajtje. Në 2011 kjo Drejtori ka lëshuar 66 fletëparaqitje për kundërvajtje, 51 fletëparaqitje penale dhe ka konfiskuar 115 m/3 dru.<sup>4</sup>

Shumë familje të Komunës së Kamenicës të hyrat vjetore i sigurojnë nga prerja e drunjve, mirëpo Komuna e Kamenicës duhet të jetë më aktive në parandalimin dhe kontrollin e sasisë së prerjes së drunjve, si dhe të kujdeset për pyllëzimin e atyre hapësirave të cilat janë shpyllëzuar nga prerjet ilegale.

## 2.5 Rregulli në administratë

Problem tjetër edhe më tutje mbetet rregulli në administratë. Përkundër asaj se Komuna ka ndërtuar një Zyrë pritëse për qytetarë, shërbyesit civil në këtë komunë nuk janë të përgjegjshëm për punën e tyre.

<sup>2</sup> Ligji nr.03/L-153 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pyjet, <http://gazetazyrtare.rks-gov.net/Documents/shqip-251.pdf>.

<sup>3</sup> Një akuzë të tillë e ka bërë këshilltari komunal Satmifer Kryeziu (LDK) në mbledhjen e 10 të Kuvendit Komunal për 2011 (e mbajtur më 31 tetor 2011), ku ka akuzuar përgjegjësit për mbrojtjen e pyjeve dhe Drejtorin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural se nuk po punojnë në parandalimin e prerjes ilegale të pyjeve. Madje ai në këtë seancë përmend edhe një rast të cilin e ka denoncuar, mirëpo Drejtoria nuk ka marrë masa.


<sup>4</sup> Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit rural. Raporti I Punës për periudhën janar-dhjetor 2011.

Vendosjen e rregullit në administratë edhe më tutje e vështirëson mos ekzistenca e një objekti të vetëm të administratës, por shpërndarja në gjashtë objekte të ndryshme. Kjo vështirëson qasjen e qytetarëve dhe kryerjen e punëve, si dhe u mundëson shërbyesve civil që të mos respektojnë orarin e punës. Për më shumë lidhur me funksionimin e administratës së Komunës së Kamenicës mund të lexoni në pjesën e të këtij raporti për administratën komunale.

### 3. Performanca buxhetore e komunës së Kamenicës

Buxheti vjetori i Komunës së Kamenicës për vitin 2012 është 7.1 milion euro. Një nivel i njëjtë i buxhetit parashihet edhe për dy vitet në vijim, ku sipas vlerësimeve buxheti i 2014 nuk do të jetë më i lartë se 7.3 milion euro,<sup>5</sup> çfarë do të thotë se për tri vite, Komuna e Kamenicës nuk parashihet zhvillim ekonomik të komunës, zhvillim nga i cili do të mund të rritej edhe buxheti komunal.

Grafikoni nr.1: Buxheti i Komunës së Kamenicës 2010-2014




Të hyrat vetanake kanë shënuar rritje të konsiderueshme gjatë 2011, duke tejkalluar planin fillestar si dhe duke tejkalluar të hyrat vetanake të 2010. Por, përkundër rritjes së konsiderueshme të të hyrave vetanake, Komuna e Kamenicës në planifikimet e saj buxhetore për 2012-2014 është treguar skeptike se do të mund të

<sup>5</sup> Komuna e Kamenicës. Buxheti për Vitin 2012. Aprovuar më mbledhjen e KK të Kamenicës, 30.9.2011. Të dhënat e njëjta mund të merren edhe nga Tabelat e Buxhetit të Kosovës për vitin 2012: <http://www.mef-rks.org/images/buxheti%20i%20RKS/Tabelat%20e%20Buxhetit%20te%20Kosoves%20per%20vitin%202012.pdf>



arkëtojë të hyra më të mëdha se ato të 2011. (shih grafikoni 2 për të hyrat vetanake 2009-2014).

Grafikoni nr.2 të hyrat vetanake ndër vite



Pjesa më e madhe e të hyrave vetanake vjen nga tatimi në pronë (mbi 232 mijë euro), taksa për regjistrim biznesi (mbi 90 mijë euro), taksa për regjistrim të automjeteve (mbi 48 mijë euro), etj. Një ngritje e të hyrave në 2011 paraqesin edhe gjokat nga inspektoratet (29 mijë euro), të cilat në vitin 2010 ishin pak mbi 5 mijë euro.

Të hyrat nga tatimi në pronë do të mund të ishin më të mëdha sikur zyrtarët e tatimit në pronë të evidentojnë dhe të regjistrojnë të gjitha objektet në territorin e Komunës. Sipas Auditorit të Brendshëm të Komunës, e meta më e madhe e evidentuar nga Auditori është dështimi i zyrtarëve për të evidentuar ndërtimet e reja. Po ashtu në shumë raste Komuna tatimon pronat si prona të papërfunduara ndërtimore, kurse në realitet ato prona janë të përfunduara.<sup>6</sup> Eliminimi i këtyre zbrastirave do të ngrihte edhe më tej të hyrat nga tatimi në pronë, si dhe do të ndikojë në regjistrimin më të mirë të pronave private në Komunën e Kamenicës.


Përkundër buxhetit të vogël dhe nevojave të mëdha, si pasojë e planifikimit jo të duhur të buxhetit, nga Buxheti i Komunës për 2011 kanë mbetur **të pashpenzuara afro 600 mijë euro**<sup>7</sup>. Fondet e pashpenzuara (133.814 euro) nga granti qeveritar nuk kanë mund të barten në 2012 dhe si të tilla i kthehen mbrapa Qeverisë.

Siç mund të shihet nga grafikoni më poshtë, 86% e shpenzimeve financohen nga granti qeveritar, 8% nga të hyrat vetanake, etj. Komuna e Kamenicës është një ndër komunat e pakta të cilat ende përfitojnë donacione nga organizatat ndërkombëtare.

<sup>6</sup> Njësia e Auditimit të Brendshëm në Komunën e Kamenicës. Raport Final i Auditimit 2010 – për të hyrat nga tatimi në pronë. 4 tetor 2011.

<sup>7</sup> 595.382,25 saktësisht.

Grafikoni nr.3: Burimi i financimit të projekteve dhe shpenzimeve



Burimi: Komuna e Kamenicës- Raporti Financiar Janar-Dhjetor 2011

#### 4. Shpenzimi i parasë publike

Mandatin e tretë qeverisës z. Surdulli e kishte filluar duke kërkuar përgjegjësi nga paraardhësi i tij lidhur me shpenzimet e parasë publike. Në një shkresë të dërguar në adresë të organeve komunale, institucionet qendrore dhe ato ndërkombëtare, Shaip Surdulli kishte denoncuar shpenzimet e shfrenuara të parasë publike.

Por si është shpenzuar buxheti komunal gjatë viteve 2010-2011?

Menjëherë me fillimin e mandatit të ri qeverisës, udhëheqësia e re kërkoi ndryshimplotësimin e Statutit të Komunës dhe Rregullores së Punës së Kuvendit Komunal. Më 16 shkurt 2010, Kuvendi Komunal formoi një komision nëntë anëtarësh i cili kishte për obligim ndryshimin dhe plotësimin e këtyre dy dokumenteve. E tëra që do të ndryshohej në Statut të Komunës ishin 6 nene të cilat u pa e nevojshme të ndryshoheshin pas rritjes së numrit të drejtorive nga 5 në 11 dhe largimit të 18 vendbanimeve nga Statuti i Komunës, pas procesit të decentralizimit. Për këto ndryshime teknike të Statutit dhe për ndryshimin e Rregullores së Punës së KK, anëtarët e komisionit morën pagë 350 euro në muaj. **Totali i ndryshimeve i kushtoi komunës 3150 Euro. Komisioni prej nëntë vetave kishte përfunduar punën pas dy takimeve.**

**Për dreka zyrtare për dy vite (2010/11) janë shpenzuar 47.583,65 Euro**, prej tyre mbi 22 mijë euro në 2010 dhe mbi 25 mijë euro në 2011. 45% e kësaj shume për dy vite është shpenzuar nga Zyra e Kryetarit (21.437,28 Euro). Zyra e Kryetarit me një staf prej 15 vetash, ka shpenzuar për dreka zyrtare sa 12 departamente tjera me një staf prej 207 vetash. Vlen të përmendet se shumë për afërsisht e njëjtë e

shpenzuar për dreka zyrtare ishte edhe më 2009 nën udhëheqjen e Begzad Sinanit, me ç'rast ishin shpenzuar 23.307,06 Euro.<sup>8</sup>

Buxheti i Komunës është dëmtuar edhe si rrjedhojë e **praktikave jo ligjore për punësimin dhe largimin e shërbyesve civil.** Për dy vite komuna ka paguar **40.600 euro për vendimet e gjykatave**, pasi që Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës (KPM) dhe gjykatat kanë konstatuar se Komuna e Kamenicës ka shkelë të drejtat nga marrëdhënia e punës. KPM ka aprovuar ankesën e 11 shërbyesve civil, 8 në vitin 2010 dhe 3 në vitin 2011.<sup>9</sup> Kurse në 8 raste tjera KPM ka vendos se ankesat kanë bazë, por ato duhet drejtuar në gjykata. Në shumicën e këtyre rasteve Komuna kishte ndërprerë kontratat në mënyrë të jashtëligjshme. Askush nuk ka dhënë përgjegjësi për humbjen e 40.600 eurove, si pasojë e vendimeve jo të drejta.

Edhe shpenzimet e telefonisë mobile janë të mëdha. Në vitin 2010 komuna ka shpenzuar në total 10.154,84 Euro, kurse në 2011 janë shpenzuar 15.362,06 euro. Totali për dy vite për mbushje të telefonisë mobile, apo siç emërtohen në raportet financiare të komunës “shpenzime të telefonisë vala 900” është 25.516,90 euro. Kjo shumë është e barazvlefshme me totalin e buxhetit të ndarë në 2011 për projektet e bujqësisë.<sup>10</sup> Për këto dy vite, më së shumti mbushje të telefonisë mobile janë shpenzuar nga Zyra e Kryetarit.

Të dhënat për **shpenzimet e parasë publike për tremujorin e parë të 2012** na lënë të kuptojmë se shpenzimet për mbushje të telefonisë mobile në 2012 mund të jenë më të mëdha se sa në 2011. Gjatë periudhës janar-mars 2012 komuna ka shpenzuar 4.302 euro për mbushje të telefonisë mobile, apo 100% më shumë se në të njëjtën periudhë të 2011.<sup>11</sup>

Grafikoni më poshtë pasqyron shpenzimet e Komunës së Kamenicës për mbushje të telefonisë mobile për vitet 2010-2011.

---


<sup>8</sup> Shifër e nxjerrë nga Raporti Financiar I Komunës së Kamenicës Janar-Dhjetor 2009, duke kalkuluar 180 faturat e papaguara për dreka zyrtare.

<sup>9</sup> Raporti Vjetor i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës 2010, mars 2011, Burimi: [http://kpmshc.rks-gov.net/repository/docs/raporti\\_2010\\_509186.pdf](http://kpmshc.rks-gov.net/repository/docs/raporti_2010_509186.pdf). Dhe Raporti Vjetor i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës 2011, mars 2012. Burimi: [http://kpmshc.rks-gov.net/repository/docs/Raporti\\_Vjetori\\_2011\\_972731.pdf](http://kpmshc.rks-gov.net/repository/docs/Raporti_Vjetori_2011_972731.pdf)

<sup>10</sup> Komuna e Kamenicës. Raporti Financiar Janar – Dhjetor 2011. Kodi buxhetor 83233 – projektet bujqësore.


<sup>11</sup> Komuna e Kamenicës. Raport Financiar për periudhën Janar-Mars 2012, i prezantuar në seancën e Kuvendit Komunal më 27 prill 2012.

Grafikoni nr.4: Shpenzimet e telefonisë mobile 2010-2011



Përveç mbushjeve për telefoni mobile, **edhe shpenzimet për telefoninë fikse** janë të mëdha. Madje këto ja kalojnë edhe shpenzimeve të telefonisë mobile. Për dy vite, nga buxheti i Komunës së Kamenicës janë shpenzuar 37.168,17 euro. Edhe në këtë kategori të shpenzimeve, në 2011 është shpenzuar shumë më shumë se sa në 2010. Për telefoni fikse në 2011 janë shpenzuar afro 6 mijë euro më shumë se më 2010. Drejtoria e Shërbimeve Publike është shpenzuesja më e madhe e telefonisë fikse, apo 66% të tërë shpenzimeve të 2011. Arsyetimi i komunës i dhënë në Raportin Financiar Janar-Dhjetor 2011 për shpenzimet e mëdha të telefonisë fikse është se administrata e komunës është e ndarë në disa objekte dhe kjo rrit shpenzimet e komunikimit. Në bazë të këtij arsyetimi i bie se Komuna e Kamenicës pjesën më të madhe të shpenzimeve të telefonisë fikse e harxhon për komunikim në mes të shërbyesve civil. Departament tjetër i cili ka shpenzuar shumë është edhe kujdesi i shëndetit primar. Në këtë sektor janë shpenzuar 177.8 euro në muaj, apo totali prej 2.133 në vit (2011). Komuna nuk ka dhënë shpjegime se përse ky sektor ka nevojë të shpenzojë aq shumë. Raporti Financiar i Komunës për 2011 nuk i paraqet shpenzimet e telefonisë fikse për të gjitha departamentet, por vetëm për 6 prej tyre, siç është paraqitur në trafikonin më poshtë:

Grafikoni nr.5: Shpenzimet e telefonisë fikse 2011 sipas departamenteve të Komunës



**Karburantet për vetura** është tjetër kategori e shpenzimeve e cila ka shënuar rritje të madhe në 2011 në krahasim me një vit më parë. Zakonisht arsyetimi i zyrtarëve komunal për rritjen e shpenzimeve për karburante të veturave është rritja e çmimit të karburanteve. Çmimi i karburanteve në treg është rritur 17% në krahasim me 2010, shpenzimet e komunës për këtë kategori janë rritur për 65%. Për dy vite Komuna e Kamenicës ka shpenzuar 140.463 euro: mbi 55 mijë në 2010 dhe mbi 84 mijë në 2011. Edhe në shpenzimet për karburante prin **Zyra e Kryetarit, e cila në vitin 2011 ka shpenzuar 29.442 euro**. Në 2011, **Zyra e Kryetarit të Komunës ka shpenzuar mbi 300% më shumë për karburante se sa në 2010**, kur ishin shpenzuar 8.847 euro. Shuma e karburanteve për vetura që ka shpenzuar Zyra e Kryetarit është më e madhe se shpenzimet për karburante që kanë shpenzur në 2011 së bashku shërbimi i zjarrfikësve, shërbimi i kujdesit primar, shërbimet publike, inspekcioni. Kryetari i Komunës shfrytëzon veturën zyrtare edhe në ditë të fundjavës dhe për nevoja jo zyrtare. z.Surdulli është ligjërues edhe në fakultetin teknik në Universitetin e Prishtinës dhe ai **shfrytëzon veturën zyrtare për të udhëtuar në Prishtinë dhe Prizren për të marrë pjesë në ligjërata**.


Në 2010, Komuna e Kamenicës ka lidhur kontratë një vjeçare me NTSH "Lindi-Oil"-Topanicë për furnizim me karburante në vlerë prej 95 mijë eurove. E njëjta kompani në 2011 ka lidhur dy kontrata me komunën për furnizim me karburante në vlerë prej 160.000 euro.

Nëse bazohemi në shpenzimet e tre mujorit të parë të 2012, shpenzimet për karburante në 2012 pritet të jenë shumë më të larta se ato të 2011. Në periudhën janar-mars 2012, Komuna e Kamenicës ka shpenzuar për karburante të veturave 13.823 euro, gjersa për të njëjtën periudhë të 2011 ishin shpenzuar 8.006 euro.<sup>12</sup>

<sup>12</sup> Komuna e Kamenicës. Raport Financiar për periudhën Janar-Mars 2012, i prezantuar në seancën e Kuvendit Komunal më 27 prill 2012.

Ashtu sikurse kanë shënuar rritje në 2011 të gjitha shpenzimet e përmendura më sipër, edhe “shpenzimet e komunalisë” kanë shënuar rritje (shih trafikonin më poshtë), edhe pse çmimi i rrymës, ujit dhe mbeturinave ka qenë i njëjtë.

Grafikoni nr.6: Shpenzimet për shërbimet komunale (rrymë, ujë, mbeturina)



Shpenzime të mëdha janë bërë edhe në **mirëmbajtjen e automjeteve**. Në 2010 për mirëmbajtje të automjeteve janë shpenzuar 25.453 euro kurse në 2011 janë shpenzuar 12.366 euro (mbi 37 mijë euro për dy vite). Vetëm Zyra e Kryetarit në 2010 për mirëmbajtje të automjeteve ka shpenzuar 10.421 euro, kjo Zyre ka tri automjete. Mirëmbajtja e një automjeti “Skoda Oktavia” ka kushtuar 2,371 euro, kontratë e lidhur me PZP “Univerzal”-Rogaqicë. Po në 2010 Komuna ka lidhur kontratë me të njejtën firmë për mirëmbajtje të automjeteve në vlerë prej 10 mijë eurosh, dhe kontratë tjetër një vjeqare me Autogarazha “Edi” në vlerë prej 7.100 euro. Në 2010 Kryetari i Komunës ka blerë dy automjete në vlerë totale prej 50 mijë eurosh, ku vetëm vetura zyrtare e Kryetarit ka kushtuar 37.500 euro.<sup>13</sup>

Në 2011, **Komuna e Kamenicës ka financuar botimin e librit të prof.dr.Azem Hajdari** – ish kandidat për deputet të Kuvendit të Kosovës nga radhët e LDK. Në pyetjet e deputetëve të KK në seancën e 30 shtatorit 2010 se përse është financuar libri i z.Hajdarit, përgjigja e Kryetarit ishte se “ai është i anës sonë”, duke mos dhënë shpjegime për kriteret e përzgjedhjes për financim apo vlerat e librit për Komunën e Kamenicës.

<sup>13</sup> Lajm i mare nga Radio Premiera:

[http://www.radiopremiera.info/pre/index.php?option=com\\_content&view=article&id=103:kryetari-blen-xhip-37-mije-e-500-euro-&catid=1:latest-neës&Itemid=50](http://www.radiopremiera.info/pre/index.php?option=com_content&view=article&id=103:kryetari-blen-xhip-37-mije-e-500-euro-&catid=1:latest-neës&Itemid=50)

Kryetari i Komunës ka paraqitur para Kuvendit Komunal edhe Raportin Financiar për periudhën Janar-Mars 2012, i cili është diskutuar në seancën e Kuvendit më 27 prill 2012. Sipas këtij raporti, **në tre mujorin e parë të 2012 Komuna ka shpenzuar më shumë se sa në të njëjtën periudhë të një viti më parë, gjersa të hyrat e Komunës janë më të vogla.**

Në prill të 2012, **nëntë veterinarë të Komunës së Kamenicës kishin paralajmëruar se do të padisin Komunën** e Kamenicës lidhur me pretendimin se Komuna kishte keqpërdorur 51.400 euro të cilat ishin alokuar nga Agjencia e Veterinës dhe Ushqimit (AVUK) në xhirollogari të Komunës. Me këto mjete do duhej të paguheshin veterinarët e kësaj komune për vaksinimin e kafshëve përgjatë viteve 2006-2011.<sup>14</sup> pas publikimit të lajmit në media se veterinarët planifikojnë të padisin Komunën, Kryetari i Komunës ia ndërprente punën nëntë veterinarëve.<sup>15</sup>

Edhe Zyra e Auditorit Gjeneral në raportin e saj për pasqyrat financiare të Komunës së Kamenicës për 2010<sup>16</sup> ka gjetur një mori parregullsish sa i përket menaxhimit të parasë publike. Parregullsitë kanë të bëjnë me mospërputhjen e të dhënave për të hyrat e paraqitura në Raportin Financiar të Komunës dhe në FreeBalance, një mospërputhje prej 271 mijë eurosh; nuk janë shpalosur informata para Auditorit Gjeneral lidhur me asetet fikse të Komunës, si dhe një mori parregullsish në procesin e prokurorimit.

---

<sup>14</sup> Zekirja Shabani. "Misteri i 50 Mijë Eurove". Gazeta Express, 26 prill 2012.

<http://gazetaexpress.com/?cid=1,14,79812>

<sup>15</sup> Zekirja Shabani. "Hakmerret Surdulli". Gazeta Express, 28 prill 2012.

<http://gazetaexpress.com/?cid=1,14,79986>

<sup>16</sup> Zyra e Auditorit Gjeneral. Komuna e Kamenicës – Raporti i Auditorit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare për fund vitin 31 dhjetor 2010. Burimi: [http://oag.rks.gov.net/Raportet%20shqip/2010/Komunat/AuditOpinion\\_Kamenica\\_2010\\_Alb.pdf](http://oag.rks.gov.net/Raportet%20shqip/2010/Komunat/AuditOpinion_Kamenica_2010_Alb.pdf)

Tab.1: Përmbledhje e shpenzimeve të Komunës së Kamenicës 2010/11 për dreka zyrtare, karburante për vetura, shpenzime telefonike fiks & mobil, mirëmbajtje të veturave, ushqim dhe pije, vendime të gjykatave

	Vala 900		Ushqim dhe Pije		Karburant per vetura		Mirëmbajtja e automjeteve		Dreka Zyrtare		Shpenzimet per vendim te gjykatave		Shpenzime telefonike	
	2010	2011	2010	2011	2010	2011	2010	2011	2010	2011	2010	2011	2010	2011
Z. e Kryetarit	3,274.84	4,562.06	13,037.30	908.00	8,847.29	29,442.01	10,421.95	4,938.90	11,366.28	10,071.00	9,549.80	0.00	0.00	0.00
Z. e Kuvendit	30	520	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	1,500.00	1,152.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Admin.& Personel	1,420.00	1,290.00	604.90	708.55	2,990.92	3,417.30	999.00	0.00	1,255.50	1,371.50	5,970.00	4,020.56	383.72	0.00
Buxhet & Financa	2,720.00	810.00	0.00	0.00	8,414.74	2,724.20	820.00	155.00	1,509.00	564.70	539.00	0.00	0.00	0.00
Sherbime publike	810.00	1,235.00	1,045.76	602.00	8,451.81	8,282.68	5,195.50	91.00	985.00	747.50	3,749.90	0.00	9,388.02	14,356.48
Zjarrfikesit	0.00	315.00	0.00	0.00	0.00	5,245.84	0.00	1,267.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
ZLK	180.00	225.00	1,448.18	256.05	1,860.43	1,511.95	200.00	95.00	500.00	450.00	11,978.16	0.00	130.80	0.00
Bujqesia	0.00	1,845	0.00	0.00	0.00	4,740.88	0.00	602.00	0.00	762.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Inspekcioni	0.00	2,280.00	0.00	55.10	0.00	1,313.10	0.00	248.00	0.00	938.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Sherbimet kadastrale	0.00	270.00	0.00	36.50	0.00	865.33	0.00	0.00	0.00	738.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Urbanizimi & kadast.	480.00	450.00	65.30	0.00	1,515.88	1,284.95	826.00	0.00	1,955.25	956.60	663.00	0.00	0.00	0.00
Administrata ne shëndetësi	275.00	370.00	44.80	40.00	905.13	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Shërbimet e kujdesit primar	175.00	70.00	354.75	626.00	10,912.32	12,718.60	5,565.79	4,096.00	480.00	1,319.95	4,129.64	0.00	2,208.34	2,133.64
Shërbimet sociale	310.00	460.00	0.00	0.00	6,292.84	3,547.45	1,013.00	874.00	0.00	57.20	0.00	0.00	314.41	719.38
DKRS	240.00	300.00	739.60	333.10	2,279.29	2,507.25	412.70	0.00	1,547.00	1,618.50	0.00	0.00	0.00	0.00
Administrata - arsim	240.00	300.00	73.15	230.50	2,569.88	1,420.84	0.00	0.00	996.50	1,544.97	0.00	0.00	861.87	269.26
Arsimi parafilior	0.00	60.00	4,356.15	4,991.60	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	521.50	0.00	0.00	200.15	769.40
Arsimi fillor	0.00	0.00	7,089.04	1,868.40	430.09	30,889.40	0.00	0.00	0.00	1,258.50	0.00	0.00	398.29	1,751.83
Arsimi mesëm	0.00	0.00	11,466.07	9,892.89	182.01	445.46	0.00	0.00	0.00	637.50	0.00	0.00	1,549.29	1,733.29
<b>Total</b>	<b>10,154.0</b>	<b>15,362.06</b>	<b>40,325.00</b>	<b>20,548.69</b>	<b>55,652.63</b>	<b>110,357.24</b>	<b>25,453.94</b>	<b>12,366.90</b>	<b>22,094.53</b>	<b>24,709.42</b>	<b>36,579.50</b>	<b>4,020.56</b>	<b>15,434.88</b>	<b>21,733.28</b>



## 5. Ivestimet kapitale

Për dy vite (2010-11) Komuna e Kamenicës ka investuar 2.539.633 euro në projekte kapitale (shih tabelën nr.2 për investimet kapitale sipas kategorive). Në vitin 2012 është planifikuar të investohen 1.314.952 euro në projekte totale. Pra për tri vite qeverisja aktuale e Komunës së Kamenicës do të investojë 3.8 milion euro në projekte kapitale.


Tab.2. Investimet kapitale sipas kategorive 2010-11

<b>Investimet</b>	<b>2010</b>	<b>2011</b>
Objekte Arsimore	245,164.87	254,806.75
Objekte Shendetesore	6,869.98	54,710.60
Objekte kulturore	-	20,000.00
Ndertimi i rrugeve lokale	420,521.87	443,362.35
Trotuaret	-	7,676.30
Kanalizimi	73,630.79	92,174.44
Ujesjellesi	26,500.00	78,296.73
Pajisje te teknologj. Inform.	-	7,060.00
Pajisje tjera	36,011.30	3,210.95
Vetura Zyrtare	49,950.00	-
Kapital tjetër	370,920.73	302,084.93
Toka	8,684.00	-
Pagesa -Vendimet Gjyqesore	18,777.25	19,219.65
<b>Totali</b>	<b>1,257,030.79</b>	<b>1,282,602.70</b>

Burimi: Raporti Financiar Janar-Dhjetor 2011

Siç shihet në fund të tabelës së mësipërme e cila pasqyron investimet kapitale 2010-2011, Komuna e Kamenicës listës së investimeve kapitale i ka bashkangjitur edhe pagesat për dëmshpërblimet gjyqësore dhe kjo kategori e pagesave nuk do të duhej të llogaritej si investim kapital.

Grafikoni nr. 7: Investimet kapitale 2012



Një destinim jo i zakonshëm i parasë publike janë edhe kontributet që Komuna e Kamenicës ka dhënë për **ndërtimin apo renovimin e xhamive**. Edhe pse në bazë të Kushtetutës, Republika e Kosovës është shtet laik dhe feja është e ndarë nga shteti, kjo nuk i ka penguar Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit Komunal që të ndajnë mjetet e grumbulluara nga taksat e qytetarëve (të gjithë pa dallim feje apo etnie) dhe t'i destinojë ato për ndërtim të objekteve fetare.

Madje mjetet e ndara për ndërtimin e xhamive, komuna e Kamenicës i klasifikon si investime kapitale, edhe pse ligjet në fuqi nuk ja lejojnë që të mbikëqyr se në realitet si po shpenzohen ato mjete dhe, për dallim nga investimet kapitale në rrugë, shkolla e spitale, Komuna nuk menaxhon me objekte fetare.

Në total për dy vite **Komuna e Kamenicës i ka ndarë 65.000 euro për ndërtimin e katër xhamive në tri fshatra të ndryshme të Komunës së Kamenicës**.

Në 2010 komuna ka ndarë 5.000 euro për ndërtimin e një aneksi të xhamisë në fshatin Hodonoc. Në vitin 2011, Komuna e Kamenicës i ka ndarë 15.000 euro për ndërtimin e xhamisë në fshatin Dajkoc dhe 15.000 euro tjera për ndërtimin e xhamisë në fshatin Berivojcë (dhe ndarjen e tokës publike). Përveç financimit të

ndërtimit, Komuna i ka ndarë edhe tokë publike në shfrytëzim të përhershëm, pa kompensim, ndërtimit të xhamisë në fshatin Dajkoc.<sup>17</sup>

Në mbledhjen e KK të Kamenicës më 27 prill 2012, me propozim të Kryetarit të Komunës, është marrë vendim që t'i ndahen 15.000 euro ndërtimit të xhamisë në lagjen e epërme të fshatit Koretin dhe 15.000 tjera për renovimin e xhamisë në lagjen e poshtme në të njëjtin fshat. Madje për xhaminë në lagjen e poshtme të fshatit Koretin mjetet janë marrë nga buxheti i projektit: nxehe qendrore dhe renovim shkollës në Karaqevë të Poshtme dhe në Kopernicë.<sup>18</sup> Xhamia në lagjen e poshtme në Koretin, për të cilën ka ndarë buxhet Komuna, është objekti i vetëm në fshatin Koretin i cili ndodhet shumë pranë rrugës së asfaltuar. Përkundër kësaj, Komuna nuk e ka shfrytëzuar rindërtimin e saj për ta larguar atë disa metra nga rruga.

Në të njëjtën mbledhje të Kuvendit Komunal, me propozim të Kryetarit të Komunës, është marrë vendim që Bashkësisë Islame të Kosovës t'i falen 300 metra katrorë, pronë komunale, për shfrytëzim deri në 40 vite.<sup>19</sup> Vendi i cili i është ndarë për shfrytëzim Bashkësisë Islame të Kosovës është vendi afër Parkut, në qendër të qytetit. Ky objekt parashihet që të ketë një kat i cili do të shërbejë për lokale për biznese, kurse pjesa tjetër të shfrytëzohet për nevojat e administratës së Bashkësisë Islame të Kosovës. Kuvendi Komunal e ka aprovuar rekomandimin e Kryetarit të Komunës për dhënien e tokës në shfrytëzim, përkundër kundërshtimit të Drejtorit të Urbanizmit.

Përveç financimit të projekteve nga buxheti i Komunës, edhe qytetarët e lokaliteteve të ndryshme kanë bashkëfinancuar projektet, kryesisht asfaltim të rrugëve. Në 2011, qytetarët kishin kontribuar me 62.474 euro për të bashkëfinancuar projekte me Komunën. Mirëpo, në 95% të rasteve Komuna nuk ka arrit që të përfundojë punën, përkundër bashkëfinancimit të qytetarëve. Edhe pse banorët e fshatit Koretin, rruga "Ibrahim Rugova", kanë grumbulluar që para një viti kanë grumbulluar 9.158 euro, ende Komuna nuk ka asfaltuar rrugën. Kompania e kontraktuar për shtrimin e kësaj rruge, "Magjistranja", ka shtruar shtresën e parë me zhavorr që në tetor të vitit të kaluar, por ende nuk ka filluar me asfaltim. Ajo çfarë mbetet e paqartë është kriteri të cilin e shfrytëzon komuna se në cilat projekte të shfrytëzojë bashkëfinancimin me qytetarë e në cilat projekte të investojë pa kërkuar bashkëfinancim. Pa një kriter të tillë, Komuna vendos në mënyrë arbitrare se cilët qytetarë të ngarkojë me kontribute shtesë e cilët jo.

<sup>17</sup> Vendimi për ndarjen e tokës për xhaminë e Dajkocit është marë më 8 prill 2011, pas kërkesës së banorëve të fshatit dhe Bashkësisë Islame të Kosovës.

<sup>18</sup> Arsyetimi i dhënë nga Kryetari i Komunës në propozimin e tij dërguar Kuvendit Komunal thuhet se "Intercooperation Helvetas" do të ndaj mjete për nxemjen qendrore në shkollën "Asllan Thaçi" në Karaqevë të Poshtme dhe si rrjedhojë mund të destinohen mjetet për financim të xhamisë.

<sup>19</sup> Komuna e Kamenicës i kishte ndarë tokë publike më herët BIK-ut, por vendi i ndarë nga Komuna nuk u kishte pëlqyer këtyre të fundit dhe me një shkresë drejtuar Kryetarit (më 6 prill 2012) kishin kërkuar një vend më të përshtatshëm. Komuna u është përgjigjur pozitivisht kësaj kërkesë duke i ndarë tokë publike tek vendi i quajtur "Plepat" në Kamenicë.

Në shumë raste Auditori i Brendshëm ka gjetur se në realizimin e projekteve ka mungesë të mbikëqyrjes efikase lidhur me fillimin e punëve, mosrespektim të kushteve të kontratës, vonesa në ekzekutimin e punëve, mos definim të qartë të kushteve të kontratës, etj.<sup>20</sup> Të njëjtin vlerësim e jep edhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm.

Një nga projektet i cili është zvarritur dhe nuk ka pasur mbikëqyrje të duhur është edhe **projekti i ujësjellësit në fshatin Koretin**. Ky projekt është kontraktuar dhe pjesa më e madhe e punëve janë kryer në mandatin e kaluar, mirëpo menaxhmenti i ri i Komunës dhe zyrtarët e prokurimit kanë dështuar të përmbyllin këtë projekt si duhet dhe ta mbikëqyrin. Për pasojë, ende banorët e këtij lokaliteti nuk mund të shfrytëzojnë ujin e ujësjellësit.

Në bashkëfinancim me komunitetin, Komuna e Kamenicës ka ndarë 33.671 euro për shtrimin e rrugës “përtej Lumit deri tek shtëpia e Osmon Kosumit” në fshatin Koretin, në gjatësi prej 800 metra dhe gjerësi katër metra. Punimet për shtrimin e kësaj rruge kishin filluar në tetor 2011, kurse ka përfunduar në qershor 2012. Pra për tetë muaj kompania punëkryese “Magjistranja” kishte zvarritur kryerjen e punëve. Mirëpo, kompania punëkryese nuk e ka kryer shtrimin e rrugës sipas “paramasës dhe parallogarisë”. Me rastin e shtrimit të kësaj rruge, kompania “Magjistrale” nuk ka bërë hapjen e kanaleve atmosferike në të dy anët e rrugës (të cilat është vlerësuar se do të kustojnë 960 euro), nuk është shtrirë zhavorri në të dy anët e rrugës së asfaltuar (e cila do të duhej të kushtonte 560 euro), kurse në shumë pjesë të rrugës asfalti nuk është shtruar në trashësi prej 7 centimetrash.

Më 2011 gjatë shtrimit të rrugës në fshatin Karaqevë është shtruar edhe rruga private deri tek dyert e Kryetarit Surdulli. Po ashtu në 2011 është shtruar edhe rruga private e përgjegjëses në Zyrën e Prokurimit znj. Hatixhe Canaj në Koretin.

Një nga problemet e shumta që përcillen tek investimet kapitale është edhe mos mbikëqyrja e duhur e tyre. Komuna e Kamenicës në bazë të ligjeve në fuqi ka përzgjedh një kompani private për të mbikëqyrur realizimin e projekteve. Në 2010 dhe 2011 Komuna ka angazhuar kompaninë NNP “Arhiko-Ing” nga Prishtina për të mbikëqyrur projektet investive. Për mbikëqyrjen dy vjeçare të të gjitha projekteve të Komunës kjo kompani është paguar 56.824 euro. Mirëpo, edhe Auditori i Brendshëm edhe Auditori Gjeneral kanë konstatuar se mbikëqyrja e punëve nuk bëhet si duhet.

Shtrimi i rrugëve në Komunën e Kamenicës zakonisht kryhet nga kompania “Papenburg&Ardiani”. Vetëm në 2010 kjo kompani ka kryer punët në shtatë projekte të ndryshme me një vlerë totale prej 430 mijë eurosh, kurse në 2011 kjo kompani ka përfituar dy tenderë në vlerë prej 174.910 euro. Edhe në 2012 kjo

---

<sup>20</sup> Njësia e Auditimit të Brendshëm të Komunës së Kamenicës. Raporti Final i Auditimit 2010 – zbatimi i procedurave të prokurimit për furnizime me mallra, shërbime dhe punë. 24 mars 2011.

kompani ka fituar tenderin prej 85.000 eurove për mbushjen e gropave. Tenderi për mbushjen e gropave ishte anuluar në mars të 2012 me arsyetimin se nuk janë paraqitur dy oferta të përgjegjshme, kurse pas rishpalljes ka fituar kompania “Papenburg&Ardiani”, edhe pse ka ofertuar me çmim më të shtrenjtë se kompania “Ardhmëria”.

Shpenzime të mëdha nga Komuna janë bërë edhe për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve. Duke u arsyetuar në emergjenca, Komuna i ka dhënë tender 15.170 eurosh kompanisë “Global Project” për të intervenuar në rrugën Hogosht-Lisockë. E njëjta kompani ka përfituar tender në vlerë prej 115.000 euro për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve më 2010 dhe 122.385 euro për mirëmbajtjen e rrugëve në 2011. Tenderi për mirëmbajtjen e rrugëve në 2011 është anuluar disa herë.

## 6. Administrata komunale

Në përgjithësi në administratën komunale të Kamenicës janë të punësuar 222 shërbyes civil. Numri i të punësuarve është rritur më 2011 në krahasim me dy vitet e mëhershme.

Tab.3: Numri i shërbyesve civil në administratën e Kamenicës 2009-2012


Vitet	2009	2010	2011	2012
Numri i shërbyesve civil	184	177 ↓	206 ↑	222 ↑

Kjo rritje e numrit të shërbyesve civil ka ardhur edhe përkundër faktit se në 2009 një pjesë e territorit të Komunës është shkëputur dhe numri i popullsisë është zvogëluar. Administrata komunale e Kamenicës ka mbingarkesë stafi. Në bazë të një vendimi të Qeverisë së Kosovës nr.10/46 i datës 3 dhjetor 2008<sup>21</sup>, vendim i cili mbetet ende në fuqi, Komunat të cilat kanë nën 100 mijë banorë duhet të kenë të punësuar një shërbyes civil për 780 banorë. Në bazë të regjistrimit të fundit të popullsisë, Kamenica ka 35.600 banorë dhe në bazë të formulës së mësipërme do të duhej të kishte maksimum 55 shërbyes civil. Çfarë do të thotë se Kamenica ka një staf administrativ prej 167 punonjësve shtesë. Vetëm Gjilani dhe Peja kanë tejkalim më të madh të numrit të të punësuarve se sa Kamenica, nëse e marrim për bazë vendimin e lartcekur të Qeverisë.

<sup>21</sup> Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr: 10/46 I datës 03.12.2008. burimi: [http://kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet\\_e\\_Mbledhjes\\_se\\_46-te\\_te\\_Qeverise\\_2008.pdf](http://kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_46-te_te_Qeverise_2008.pdf)

Është e paarsyeshme që në një Komunë e cila ka më pak territor dhe numër banorësh se sa që ka pasur para vitit 2010, të ketë numër rekord të të punësuarish në administratën lokale.

Grafikoni nr.8: Të punësuarit në administratën lokale sipas departamenteve



Në pjesën në vijim do të pasqyrojmë qeverisjen komunale sipas disa departamenteve në Komunën e Kamenicës:

### 6.1 Zyra e Kryetarit

Zyra e Kryetarit përbëhet prej: kryetarit, dy nënkryetarë, katër zyrtarë të prokurimit, Auditori i Brendshëm, menaxheri i personelit, tre zyrtarë për informim, zyrtari ligjor, shoferi dhe një përgjegjës administrativ.

Kryetari Surdulli në zgjedhjet lokale të 2009 ka fituar mandatin e tretë qeverisës. Deri në zgjedhjet e ardhshme në vjeshtën e 2013 ai do të ketë kaluar në postin e

Kryetarin të Komunës plot 11 vite, e që njëherit është kryetari që ka qeverisur më së shumti me një komunë, në krahasim me të gjitha komunat tjera të Kosovës. Z.Surdulli me kualifikim magjistër njëherit është edhe asistent ligjërues në Universitetin e Prishtinës dhe në Universitetin e Prizrenit. Rugën deri në ligjërata ai e përshkon me automjetin zyrtar të Komunës, i cili është blerë në fillim të 2011 me vlerë prej 37.500 euro. Automjeti zyrtar përdoret edhe për punë jo zyrtare dhe gjatë vikendeve. Zyra e Kryetarit është një nga njësitë e cila ka shpenzuar më së shumti në krahasim me njësitë tjera të Komunës, siç e dëshmojnë edhe të dhënat nga raportet financiare të Komunës për 2010 dhe 2011.

Shaip Surdulli ka qenë dhe është i dyshuar për disa raste të keqpërdorimit të detyrës zyrtare. Njësia për Krime Ekonomike në Gjilan e ka hetuar z. Surdullin lidhur me projektin e Palestrës Sportive, lidhur me objektin e ProCredit Bank i cili është i ndërtuar në pronë komunale, mos kryerjen e punëve në varrezat e dëshmorëve, etj. Disa nga këto raste ende nuk janë përmbyllur. Rasti më i rëndë i shkëljes së detyrës zyrtare është ai i rregullimit të varrezave të dëshmorëve në lagjen “Malësia”. Gjatë mandatit të dytë të qeverisjes, z. Surdulli kishte angazhuar kompaninë “Goni” nga Prishtina që të rregullojë varrezat e dëshmorëve. Si kompensim, kompanisë “Goni” i ishte dhënë e drejta që të ndërtojë një objekt kolektiv banesash në qendër të qytetit. Përderisa kompania ka ndërtuar banesën kolektive, nuk është bërë asnjë punë në rregullimin e varrezave që nga viti 2007. Komisioni mbikëqyrës i punëve në raportin e tij në 2007 kishte konstatuar se të gjitha punët janë kryer tek varrezat. Në 2010 e njëjta kompani kishte filluar punët në rregullimin e varrezave, tri vite pasi që ishte konstatuar se puna në varreza ishte përfunduar si duhet. Por edhe pas fillimit të punëve, asgjë nuk është kryer tek varrezat e dëshmorëve në lagjen “Malësia”. Ky rast është në procedurë gjyqësore.

Kryetari ka edhe dy nënkryetarë. Njëri nga ta është nga partneri i koalicionit AAK z. Lulzim Leci. Z. Leci është kryetar i AAK për Kamenicë dhe ka qenë zëvendësministër i Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale. Edhe pse asnjëherë nuk është hetuar zyrtarisht, Leci dyshohet për shumë raste korruptive. Në prag të zgjedhjeve parlamentare të 2007, shoqëria civile kishte përfshirë z. Leci në listën e zezë të kandidatëve për deputetë të Kuvendit të Kosovës. Z. Leci së fundmi është zhvendosur me vendbanim të përhershëm në Hajvali dhe rrugën për atje e përshkon me automjet zyrtar. Z. Leci së fundmi nuk ka qenë i angazhuar në punët e Komunës për shkaqe shëndetësore.

## **6.2 Zyra e Prokurimit**

Sipas organogramit të Komunës, prokurimi funksionon në kuadër të Zyrës së Kryetarit. Në njësinë për prokurim janë të punësuar katër veta: një me fakultet dhe tre me shkollë të mesme.

Pasi Kryetari largoi nga puna në mënyrë të jashtëligjshme Menaxherin e Prokurimit z.Hasan Keqmezi, në vend të tij emëroi Sadik Thaqin. Sadik Thaqi nuk është i kualifikuar për të menaxhuar me Njësinë e Prokurimit ngase kualifikimi i tij më i lartë është shkolla e mesme. Në bazë të Ligjit për Prokurim Publik, Njësia e Prokurimit duhet të menaxhohet nga një person me edukim të lartë dhe i certifikuar për prokurim. Person tjetër i punësuar në Njësinë e Prokurimit është edhe Hatixhe Canaj, po ashtu me shkollë të mesme, e cila në mandatin e dytë të z. Surdulli (2002-2007) ishte e punësuar si sekretare në Zyrën e Kryetarit.

Edhe pse në Komunën e Kamenicës ka persona të cilët janë të certifikuar për punët e prokurimit, Komuna nuk ka hapur konkurs për Menaxher të Prokurimit.

Auditori i Brendshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kanë gjetur plotë parregullsi në menaxhimin e Njesisë së Prokurimit.

### **6.3 Drejtoria e Administratës së Përgjithshme**

Një nga premtimet e Kryetarit të Komunës z. Surdulli ka qenë edhe rishikimi i vendeve të punës në administratë. Menjëherë me marrjen e mandatit, z. Surdulli në janar të 2010 me dy vendime të ndara përjashtoi nga puna 48 zyrtarë të pranuar nga udhëheqësia e kaluar e komunës. Këta zyrtarë ishin pranuar pa konkurs dhe me kontratë mbi vepër. Mirëpo në mesin e tyre ishin edhe 3 zyrtarë të cilët Komuna dhe vetë z.Surdulli e dinin që nga fillimi se kishin kontratë të rregullt dhe ishin pranuar me procedurë ligjore.

Pas largimit të 48 punonjësve nga puna, menjëherë më 2 prill 2010, Komuna shpalli konkurs për pranimin e 33 punonjësve të ri të cilët do të zëvendësonin ata të larguarit. Pranimi i punonjësve të rinj u bë në baza partiake ku punonjës të rinj u pranuan anëtarë të LDK dhe AAK. Se për pranimet e stafit civil kishte gisht politika e ka pranuar edhe vetë Kryetari Surdulli në një intervistë në Radio “Premiera” ku kishte deklaruar se “se në pranimet e stafit civil ka pasur gisht politika, mirëpo janë pranuar njerëz të të gjitha partive.”<sup>22</sup> Një nga të punësuarat në këtë konkurs ishte edhe ish kandidatja për Kryetare të Komunës nga radhët e LDD znj. Nexhmije Kallaba, e cila pas zgjedhjeve kaloi në LDK dhe u punësua si Zyrtare për Integritet Evropiane, edhe pse ajo nuk ka kualifikimin e duhur për këtë pozitë. Në të njëjtin konkurs u pranua edhe Shaban Canaj si Zyrtar për Vlerësim të Rrezikut, person i cili kishte qenë vëzhgues i zgjedhjeve nga radhët e LDK. Po nga LDK u pranua edhe Refik Berisha si Zyrtar në Zyrën e Pranimet, me kualifikim të shkollës së mesme kurse në vend të tij kishin konkurruar së paku dy veta me diplomë fakulteti.

---

<sup>22</sup> Radio “Premiera”. Intervistë me Kryetarin e Komunës Shaip Surdulli. Maj 2010.



Pas largimit të 48 personave nga puna, KPM në 2010 gjeti se Komuna e Kamenicës kishte larguar nga puna padrejtësisht së paku tre persona (KPM ka vlerësuar se nga puna padrejtësisht janë larguar Nehat Rudhani dhe Njazi Kryeziu). Për këta dhe raste tjera të shkeljes së të drejtave të punëtorëve Komuna e Kamenicës vetëm për vendimet gjyqësore ka paguar për dy vite 40.600 euro dëmshpërblim punëtorëve të larguar nga puna. Askush nuk ka dhënë përgjegjësi për humbjen e 40.600 eurove, si pasojë e vendimeve jo të drejta.

Më 19 mars 2010, në objektin e Komunës së Kamenicës është dashur të intervenojë Policia e Kosovës pas rrahjes që ka ndodhur në mes të Drejtorit të Administratës së Përgjithshme Enver Avazi dhe ish-Menaxherit të Zyrës së Prokurimit Hasan Keqmezi. Pas kësaj rrahjeje, Kryetari Surdulli kishte shfrytëzuar rastin të largojë nga puna Menaxherin e Prokurimit. Mirëpo edhe ky largim nga puna ishte i jashtë ligjshëm pasi që gjykata kishte vendosur në favor të z. Keqmezi dhe Komuna ishte detyruar ta kompensojë z. Keqmezi me mbi 7.000 euro për kohën që nuk kishte punuar si dhe duhej ta kthente në vendin e tij të punës. Komuna nuk e ka respektuar vendimin e gjykatës duke mos e kthyer z. Keqmezi në Zyrën e Prokurimit por duke e emëruar atë Përgjegjës për Punë Juridike në Drejtorinë e Kulturës. Në këtë vendim të Komunës është ankuar z. Keqmezi dhe rasti ndodhet në gjykatë.

KPM ka vendosur edhe në favor të punëtorit Ramadan Rexhepaj, të cili i është ndërruar vendi i punës nga Shpërndarës i faturave të tatimit, është transferuar në Drejtorinë e Shërbimeve Publike si mirëmbajtës i ambientit. Vendimi i Komunës për ndërrimin e vendit të punës ishte bërë në mars të 2011, kurse më 15 gusht 2011 KPM ka vendosur në favor të Ramadan Rexhepajt duke e obliguar Komunën e Kamenicës që në afat prej 15 ditësh ta kthejë punëtorin në vendin e tij të punës. Edhe pas tetë muajve, Kryetari Surdulli nuk e ka kthyer në vendin e tij të punës z. Rexhepaj duke bërë shkelje të vendimit të KPM. Ramadan Rexhepaj ka parashtruar padi në Gjykatë, mirëpo rasti është bllokuar në Gjykatën e Kamenicës dhe punëtorit Rexhepaj vazhdon t'i shkelet e drejta e tij e punës.

Problem tjetër me administratën e Komunës së Kamenicës mbetet edhe kualifikimi i stafit administrativ. Nga 222 të punësuar vetëm 86 janë me fakultet apo 38.7%. Edhe pse në konkurset e shpallura nga Komuna, qoftë nga qeverisja aktuale apo edhe nga qeverisjet e kaluara, kanë konkurruar të kualifikuar me fakultet, prapë se prapë janë pranuar shërbyes civil me shkollë të mesme.

Problem tjetër në administratën e Kamenicës janë edhe **të punësuarit me kontratë mbi vepër**. Të punësuarit me kontratë mbi vepër nuk llogariten si të punësuar të rregullt dhe nuk gjenden në listat e shërbyesve civil dhe listën e pagave. Këta të punësuar paguhen nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve. Me ligjet e reja të shërbimit civil nuk lejohet punësimi me kontratë mbi vepër. Me këtë lloj kontrate janë të punësuar disa persona në Komunën e Kamenicës, por numri i saktë i tyre nuk bëhet i ditur.

Një nga të punësuarit në këtë mënyrë është edhe Fitore Ajvazi e cila është punësuar si Zyrtare Administrative në Zyrën për Tatim në Pronë në Drejtorinë për Ekonomi, Buxhet dhe Financa. Për pranimin në punë të kësaj të fundit, Kryetari Surdulli i ballafaquar me pyetjet e deputetëve në seancën komunale, kishte deklaruar se pranimin e “Fitore Ajvazit në punë e kishte bërë për shkak se e ndjente obligim moral ndaj vjehrrit të saj Hazir Ajvazit, ngase që nga themelimi zyret e LDK kanë funksionuar në kuadër të lokalit të këtij të fundit.”<sup>23</sup>

Përveç Fitore Ajvazit, edhe së paku dhjetë kontrata tjera janë nënshkruar përmes kontratave mbi vepër:

Tab. Nr.4: Kontratat mbi vepër të nënshkruara në 2010 dhe 2011

Emri dhe mbiemri	Pozita	Vendbanimi	Paga	Kontrata e lidhur më:	Afati i kontratës
Enver Cakolli	Vozitësi i Ngarkuesit “Catapult” 966	Krilevë	4 € për një orë punë të vozitjes së ngarkuesit	22.04.2010	Nuk ceket
Naim Mavriqi	Vozitësi i Nënkyetarit të Komunës	Kamenicë	209.30 €	24.06.2010	Nuk ceket
Bojana Jovic	Asistente e Shefit të Zyres Lokale për Komunitete	Hajnoc	209.30 €	13.07.2010	Nuk ceket afati kohor, vetëm thuhet deri në kthimin e punëtore e cila është në pushim
Enver Bajrami	Eliminimi i qenve endacak	Kamenice	350 €	29.10.2010 (dhe kontrata e dytë e lidhur më 4.10.2011)	31.12.2010 (kontrata e dytë deri më 18.12.2011)
Maliq Borovci	Eliminimi i qenve endacak	Kamenice	350 €	4.10.2011	18.12.2011
Maliq Avdyli	Eliminimi i qenve endacak	Kamenice	350 €	4.10.2011	18.12.2011
Liridona Fazliu	Zyrtare në Zyrën për Tatim në Pronë	Kamenice	214.50€	14.2.2011	Deri në kthimin e punëtore nga pushimi

<sup>23</sup> Marrë nga procesverbali i mbledhjes së 8 të Kuvendit Komunal për 2010, mbajtur më 30 shtator 2010.

					i lehonisë
Rexhep Biqkaj	Roje Pylli në Drejtorinë për Bujqësi	Hogosht	238.78 €	13.4.2012	16.08.2012
Driton Lipovica	Roje Pylli në Drejtorinë për Bujqësi	Polickë	238.78 €	13.04.2012	16.08.2012
Skender Qehaja	Teknik i Pylltarisë në Drejtorinë për Bujqësi	Shipashnicë e Poshtme	285.97 €	25.4.2012	

Asnjë nga këta nuk është punësuar përmes konkursit. Përzgjedhja ka qenë arbitrare dhe në bazë të afërsive partiake dhe familjare.

Rexhep Biqku i cili ka lidhë kontratë mbi vepër me Komunën si roje pylli është vëlla i anëtarit të Kuvendit Komunal nga radhët e LDK, Jeton Biqku.

Gjatë hulumtimeve tona kemi vërejtur se ekzistojnë keqpërdorime sa i përket **koeficientit të pagave të shërbyesve civil**. Në një dokument të siguar nga Zyra e Personeli dhe i cili mban datën 04/06/2010, paga e shoferit të Kryetarit, person me kualifikim të mesëm, është më e lartë se e shumë personave tjerë me kualifikim të lartë dhe fakultet. Paga e shoferit të kryetarit ishte 250.8 euro, kurse e shumicës së shërbyesve civil me fakultet ishte 214.5 euro.<sup>24</sup>

Drejtorja e Administratës ka qenë përgjegjëse edhe për **rekrutimin e njerëzve për të kryer regjistrimin e popullsisë**. Edhe kjo ka qenë një mundësi për të punësuar njerëz partiak. Në komunën e Kamenicës janë pranuar 24 kontrollorë (kurse kanë aplikuar 125 kandidatë) dhe 127 regjistruer (kurse kishin aplikuar 600 kandidatë). Edhe pse sipas konkursit kontrollorët do të duhej të ishin me kualifikim të lartë, Komuna ka angazhuar kontrollor me shkollim të mesëm duke lënë jashtë procesit kandidatë me shkollim të lartë. Po ashtu ka pasur raste kur si kontrollor të procesit të regjistrimit janë pranuar njerëz të cilët vetëm se kanë qenë të punësuar dhe kanë marrë një pagë. Gjatë raportit të Drejtorit të Administratës para KK, drejtori është akuzuar se ka pranuar njerëz partiak, njerëz të tij familjar, janë punësuar numër i vogël i femrave dhe persona jo të kualifikuar. Enver Ajvazi është akuzuar se në këtë proces ka punësuar mbesen e tij Gëzime Fejzullahun.

Punën dhe efikasitetin në administratë e vështirëson edhe **shpërndarja e administratës në shumë objekte** dhe kushtet jo të mira për punë për shkak të objekteve të vjetruara dhe jo të përshtatshme për punë zyreje. Mirëpo ky problem

<sup>24</sup> Zyra e Personelit - Komuna e Kamenicës. Regjistër I Punëtorëve të Administratës Komunale. Datë 04/06/2010.

pritet të zgjidhet së shpejti pas ndërtimit të objektit të ri të Komunës, me financim të Komisionit Evropian.

## **6.4 Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor**

Kjo drejtori udhëhiqet nga AAK – partner i koalicionit të LDK. Drejtoria ka 6 të punësuar duke përfshirë edhe Drejtorin e Drejtorisë.

Drejtori i kësaj Drejtorie në vitin 2011 ka pasur një konflikt me Kryetarin e Komunës lidhur me objektin e ndërtuar në pronë komunale afër tregut të qytetit. Biznesmeni Afrim Sijarina kishte tejkaluar lejen e ndërtimit duke ndërtuar në pronë komunale. Kjo ndërtesë ka prishur edhe planin urbanistik të Komunës, duke pamundësuar që rreth-rrotullimi afër tregut të ndërtohet sipas parametrave të paraparë urbanistike. Megjithëkëtë, Kryetari i Komunës kishte bërë presion ndaj Drejtorisë së Urbanizmit që t'i lëshohet leja e punës, edhe pse ndërtimi shkelte rregullat e ndërtimit. Pas refuzimit të Drejtorit të Urbanizmit z. Ilir Kastrati për t'i dhënë leje ndërtimi për pjesën e ndërtuar në pronë të Komunës, Kryetari kishte kërkuar nga Kuvendi Komunal që të ndërmarrë një vendim të tillë. KK ka marrë vendim që z.Sijarina t'i lejohet që të shkel lejen e ndërtimit.

Përveç kësaj, Drejtori i Urbanizmit kishte kundërshtuar kërkesën e Kryetarit dhe vendimin e KK për t'i falur tokë komunale Bashkësisë Islame për të ndërtuar objekt afër parku të qytetit.

Në këtë drejtori për vite të tëra bëhen shkelje ligjore lidhur me lëshimin e lejeve. Në shumë raste shërbyesit civil të Drejtorisë së Urbanizmit i plotësojnë vetë dokumentacionet e palëve, qoftë kërkesat për leje ndërtimi apo pranime teknike, në vend se këto kërkesa të plotësohen nga palët me ndihmën e avokatëve apo arkitektëve. Në këtë mënyrë shërbyesit civil u marrin pare qytetarëve dhe pastaj vendosin vetë për lëndën që u dorëzohet. Personi i cili më së shumti përfolet për shkelje të tilla është Mehmet Thaçi – Përgjegjës për Planifikim në Drejtorinë e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor. Për këtë problem në Drejtorinë e Urbanizmit, por edhe në Drejtorinë e Gjeodezisë, është diskutuar edhe në seancën e KK.

Gjatë një inspektimi të bërë nga Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor Komunës së Kamenicës i është rekomanduar që urgjentisht të hartohen Plani Zhvillimor Komunal (PZHK) dhe Plani Zhvillimor Urban (PZHU); planet rregulluese të “Lagjes Malësia” dhe “Lagjes të Spitalit” të harmonizohen me aktet ligjore në fuqi; të plotësohet njësia për planifikim hapësinor, siç kërkohet me Ligjin për Planifikim Hapësinor; si dhe, inspektorati i MAPH kishte konstatuar se dhënia e lejeve

urbanistike dhe ndërtimore është në kundërshtim me Ligjin për Planifikim Hapësinor, pa u miratuar PZHK dhe PZHU.<sup>25</sup>

## 6.5 Drejtoria e Inspektoratit

Në Komunën e Kamenicës janë të punësuar 12 inspektorë të ndryshëm, por jo të gjithë inspektorët veprojnë në kuadër të Drejtorisë së Inspektoratit. Dy inspektorë punojnë në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë (inspektori i pylltarisë dhe inspektori i veterinarisë), kurse dhjetë të tjerët punojnë në kuadër të Drejtorisë së Inspektoratit. Edhe në kuadër të Drejtorisë së Inspektoratit funksionon një inspektor i veterinarisë, kurse tjetri është i vendosur në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë.

Në përgjithësi inspektorët e komunës nuk janë mjaft aktivë në punën e tyre. Sidomos inspektori i ambientit, inspektorët e tregut dhe inspektori i pylltarisë. Komuna përballlet me probleme të mëdha ambientale, jo formalitetit të lartë dhe problemin e prerjes ilegale të pyjeve.

## 7. Rastet e ngritura pranë Gjykatës Komunale

Punëtorët të cilët janë larguar padrejtësisht nga puna ose u është ndërruar vendi i punës, janë ankuar në KPM dhe Gjykatën Komunale. Përderisa shërbyesit civil kanë marrë përgjigje të shpejtë nga KPM, rastet në Gjykatën Komunale janë zvarritur.

Ka raste që KPM ka vendosur në favor të punëtorëve, mirëpo Komuna nuk i ka respektuar vendimet e KPM. Të dëmtuarit kanë paraqitur ankesë pranë Gjykatës. Raste të këtilla janë:

- Hasan Keqmezit – për të cilin KPM ka vendosur se duhet të kthehet në vendin e tij të punës në Njësinë për Prokurim. Komuna nuk ka respektuar këtë vendim, kurse Keqmezi ka parashtruar padi pranë Gjykatës Komunale dhe nuk ka marrë përgjigje për afro një vit.
- Ramadan Rexhepi – të cilit padrejtësisht i është ndërruar vendi i punës dhe KPM ka vendos në favor të tij, mirëpo Komuna nuk ka respektuar këtë vendim. I njëjti e ka dërguar rastin në Gjykatë mirëpo ende nuk ka marrë përgjigje;
- Shefqet Rexha – ish punonjës i administratës i cili është larguar nga puna dhe ka paditur Komunën. Në qershor 2012 z.Rexha ka fituar rastin në Gjykatë dhe Komuna tani obligohet të ia kompensoj pagën për largim të paligjshëm.

<sup>25</sup> Inspektimi i rregullt i kryer nga Inspektorati I MSAPH, Procesverbali nr.rendor 11/INS-P-10 SLB-20, datw 12.5.2011.

Të dëmtuarit akuzojnë Kryetarin e Gjykatës Komunale z. Zijadin Spahiu se me qëllim po i zvarrit lëndët të cilat janë kundër Kryetarit Surdulli.

Zijadin Spahiu së fundmi ka përfituar nga një vendim i Kuvendit Komunal (seanca e KK e datës 30 prill 2012) të cilit i është ndarë tokë komunale, pa ndonjë arsytim. Kërkesën për ndarjen e tokës komunale e ka parashtruar bashkëshortja e Zijadin Spahiut, znj. Naziktere Spahiu – e cila njëherit është përgjegjëse për pronë në Komunën e Kamenicës.

## 8. Arsimi

Një nga premtimet e dhëna nga z. Surdulli gjatë fushatës elektorale ka qenë edhe përmirësimi i kushteve në arsim. Gjatë dy viteve të qeverisjes së tij me Kamenicën ka pasur investime në infrastrukturën shkollore. Investimi më i madh ka qenë ndërtimi i një shkolle pesëkatëshe në fshatin Shipashnicë e Poshtme (për investimet tjera në infrastrukturën shkollore shih pjesën për investimet kapitale dhe pjesën për realizueshmërinë e premtimeve).

Gjendja e arsimit në Komunën e Kamenicës nuk është e kënaqshme. Mungon siguria në shkolla, sidomos në shkollat e mesme në fshatrat Hogosht dhe Rogoqicë. Në këto dy shkolla edhe kushtet për ushtrimin e mësimin janë jo të mira. Shkolla e Hogoshtit është e vjetruar dhe përkundër premtimit të Kryetarit Surdulli se do të intervenojë në renovimin e shkollës së Hogoshtit një gjë e tillë ende nuk ka ndodhur. Gjersa në shkollën e Rogoqicës mësimi ushtrohet në tri ndërrime, orët mësimore janë të shkurtra, dhe në sezonin e dimrit, ndërrimi i tretë tërë mësimin e ushtron pas rënies së territ (nga ora 16.00 deri në ora 20.10).

Tab. Nr.5: të dhënat mbi arsimin fillor dhe të mesëm në Komunën e Kamenicës

Klasët	Nr. nxënësve	Nr. paraleleve	Nr. mesimdhënesve
Çerdhet	70	-	12
Parashkollor	-	-	-
1-5	2261	164	517
6-9	2218	131	
10-13	2022	80	208

Keqpërdorime të mëdha ndodhin edhe në pranimin e stafit mësimdhënës. Në dy konkurset e shpallura në 2010 dhe 2011 janë evidentuar shumë parregullsi. Në të dy konkurset procesi i intervistimit është bwrw vetëm formalisht. Janë pranuar mësimdhënës pa diploma, të pakualifikuar dhe persona partiak.

Nora Ramadani, vajza e përgjegjësit për arsim në Drejtorinë e Arsimit Xhavit Ramadani është pranuar si mësimdhënëse në shkollën fillore në Kamenicë, edhe pse në kohën e pranimit asaj i mungonte diploma e fakultetit. E njëjta kishte marrë orë mësimore të edukatës qytetare edhe në shkollën fillore në Koretin. Në kohën kur Nora Ramadani është pranuar si mësimdhënëse pa diplomë, Besnik Rexha i diplomuar në edukatë qytetare nuk ishte pranuar në punë.

Pa diplomë ishte pranuar edhe Xhevrije Krasniqi si mësimdhënëse e psikologjisë në shkollën e mesme në Hogosht, me gjysmë orari. Në ndërkohë znj.Krasniqi ka diplomuar dhe i janë ndarë orët e plota, duke ia mundësuar që të marrë edhe orët e psikologjisë në shkollën e mesme në Kamenicë.

Në shkollën e re fillore në lagjen “Malësia” si sekretare e shkollës është pranuar në punë Hyrije Morina, gruaja e menaxherit të personelit në Zyrën e Kryetarit Sami Morina. Konkursi për sekretar shkolle nuk ishte publikuar në hyrje të shkollës dhe në vendet e shpalljeve në Komunë, ashtu siç kërkohet me ligj. Madje edhe vetë drejtori i shkollës nuk kishte njohuri për një konkurs të tillë. Vlen të përmendet se z. Surdulli kishte larguar nga puna ish-menaxherin e personelit Shefqet Rexhen si dhe gruan e këtij te fundit Filloreta Rexhen – e pranuar pa konkurs si motër medicinale në QKMF të Kamenicës. I njëjti rast i keqpërdorimit është përsëritur edhe në këtë mandat.

Pas konkursit për pranimin e mësimdhënësve në vitin shkollor 2010/2011 i ishin marrë lëndët mësimdhënësve Sadri Bunjaku dhe Azem Zylfiu. Të njëjtëve u janë kthyer orët pas parashtrimit të ankesave.

Në fillim të çdo viti shkollor ekzistojnë ankesa të shumta të mësimdhënësve për mënyrën e ndarjes së orëve. Ndarja e orëve bëhet nga Drejtoria e Arsimit, pa u konsultuar me drejtorët e shkollave. Ekzistojnë raste kur:

- një mësimdhënësi i mundësohet që tërë orët mësimore t’i zhvillojë brenda dy ditësh dhe të marrë tri ditë të lira;
- në raste tjera mësimdhënësve të kualifikuar nuk u ndahen orët për të cilët janë të kualifikuar, por i jepen edhe orë tjera për të cilat ai mësimdhënës nuk është i kualifikuar; në shumë raste të zëvendësimeve nuk hapet fare konkurs por pranohen persona partiak;
- ka një numër të mësimdhënësve të pakualifikuar për lëndët që i japin.

Drejtoria e Arsimit nuk përgjigjet në të gjitha ankesat e parashtruara, edhe pse kjo kërkohet me ligj.

Edhe në ndarjen e bursave për studentë ka pasur shumë ankesa. Komuna ka ndarë 56 bursa, nga 50 euro në muaj për studentët më të dalluar të Komunës. Për këto bursa kanë aplikuar 95 studentë. Kriter për marrjen e bursave ka qenë studimi në lëndë deficitare dhe nota më e madhe mesatare. Mirëpo ka shumë të atillë që kanë përfituar bursa edhe për lëndët që nuk janë deficitare, siç janë juridiku edhe edukimi. Përkundër insistimit të deputetëve të KK që të publikohen të dhëna të

detajuara për përfituesit e bursave, siç janë emri, mbiemri, emri i prindit, vendbanimi, nota mesatare dhe fusha e studimit, Komuna nuk e ka bërë një gjë të tillë, por ka publikuar vetëm emrin dhe mbiemrin e përfituesit të bursës.

Udhwheqwsja e Drejtorisw sw e Arsimit nuk është kompetente në kryerjen e punës së vet. Në punën e saj interferon rregullisht Kryetari i Komunës, por edhe planifikimet e kësaj drejtorie janë të mangëta. Për dy vite radhazi, si pasojë e planifikimit jo të mirë buxhetor, Drejtoria e Arsimit në fund të vitit ka mbetur pa buxhet për mallra dhe shërbime, çfarë ka bërë që të mos mund të blehen me kohë lëndët djegëse për shkolla.<sup>26</sup>

## 9. Shëndetësia

Në mjekësinë primare në Komunën e Kamenicës janë të punësuar 144 persona, prej tyre 20 mjekë. Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Kamenicë ka hapësira të mjaftueshme për punë, mirëpo nuk janë bërë investime për një kohë të gjatë. Drejtor i QKMF është Ismet Morina, i afërt me LDK. Përveç QKMF, në Komunën e Kamenicës ekzistojnë edhe 4 Qendra të Mjekësisë Familjare (Rogoqicë, Hogosht, Topanicë dhe QMF te Kisha Serbe në Kamenicë) dhe 9 Ambulanta të Mjekësisë Familjare (AMF). AMF-të nuk funksionojnë me rregull në shumicën e fshatrave.

Edhe pse për shumë vite funksionon shërbimi i stomatologjisë, punët në këtë repart nuk kryhen me rregull. Mjekët stomatolog në repartin e stomatologjisë nuk tregojnë kujdesin e duhur ndaj pacientëve, duke i dekurajuar ata që të mos paraqiten në QKMF, por t'i vizitojnë klinikat a tyre private. Të dy stomatologët në QKMF posedojnë edhe klinikat e tyre private.

Auditori i Brendshëm ka identifikuar disa raste kur zyrtarët e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), janë furnizuar me mallra dhe shërbime, ende pa u zotuar mjetet. Faturime të tilla në 2010 kanë ndodhur në së paku pesë raste, ku QKMF së pari ka blerë mallrat e tek pastaj Komuna i ka zotuar mjetet për pagesën e faturës. Kjo ka rritur rrezikun e shtimit të faturave të papaguara dhe rritjen e obligimeve të Komunës.<sup>27</sup>

<sup>26</sup> Për këtë është diskutuar dhe në mbledhjen e 10 të Kuvendit Komunal për 2011, mbajtur më 31 tetor 2011.

<sup>27</sup> Njësia e Auditimit të Brendshëm të Komunës së Kamenicës. Raporti Final i Auditimit 2010 – shpenzimet për mallra dhe shërbime në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare. 19 prill 2011.



## 10. Transparenca

Në përgjithësi vërehet një përparim i vogël sa i përket nivelit të transparencës në Komunën e Kamenicës. Por edhe më tutje qasja e Komunës lidhur me transparencën është më shumë reaktive, në kuptimin e asaj që ofrohet informacioni i kërkuar, por nuk bëhet shumë në mënyrë aktive që i tërë dokumentacioni i Komunës të jetë publik për gjithkënd.

Uebfaqja e Komunës së Kamenicës është funksionale dhe përmbajtja e saj ka shkuar duke u përmirësuar nga viti në vit. Ekzistojnë informacione dhe disa dokumente të publikuara. Për shembull të gjitha procesverbalet e Kuvendit Komunal publikohen me rregull që nga janari i 2011.

Mirëpo në këtë uebfaqe nuk gjenden dokumentet më të rëndësishme të Komunës.

Të gjithë drejtorët e drejtorive dhe Zyra e Kryetarit paraqesin raportet të rregullta të punës për çdo tre muaj dhe raporte të përgjithshme vjetore. Asnjë nga këto raporte nuk është publik në uebfaqen e Komunës. Edhe pse Ligji për Menaxhimin e Financave Publike, neni 45.4, obligon Kryetarin e komunës që pas paraqitjes së raportit financiar në Kuvend të njëjtin ta publikojë edhe në uebfaqe, Komuna nuk ka publikuar asnjë raport financiar në uebfaqen e saj zyrtare.

Uebfaqja po ashtu nuk përmban informata as për personin përgjegjës për qasje në dokumente publike, ashtu siç kërkohet me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.

Tabela më poshtë pasqyron nivelin e përmbajtjes së uebfaques së Komunës së Kamenicës.

Tabela nr.6: Vlerësim i përmbajtjes së uebfaques së Komunës së Kamenicës

Dokumenti	2010				2011				2012
	I	II	III	IV	I	II	III	IV	I
Raporti i Punës së Kryetarit	x	√	x	x	x	x	x	x	x
Raporti financiar (buxhetor) i Komunës	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Administratës	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Arsimit	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mir.Sociale	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Inspektionit	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Ekonomia, Buxheti dhe Financa	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Kadastrri, Gjeodezia dhe Pronësia	x	x	x	x	x	x	x	x	x

Shërbimet Publike	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Kulturë, Rini dhe Sport	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Mbrojtje dhe Shpëtim	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Urbanizmi dhe Planifikimi Hapsin.	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet dhe njoftimet e Zyrës së Prokurorimit	Janë publikuar 34 njoftime të Zyrës së Prokurorimit. Ky numër i njoftimeve është shumë i vogël në krahasim me aktivitetet e prokurorit. Vetëm në 2010 Zyra e Prokurorimit ka nënshkruar 144 kontrata.								
Raportet e Njesisë së Auditimit të Brendshëm	Njësia e Auditimit të Brendshëm ka paraqitur në Kuvend raporte të auditimit për të hyrat vetanake, arsimin, QKMF, etj. Asnjë nga këto raporte nuk është publike në uebfaqen e Komunës.								
Procesverbalet e Kuvendit Komunal	x			√			√		
Rregulloret Komunale	x			x			x		
Vendimet e Kuvendit Komunal	x			√			√		
Rregullorja e Punës së Kuvendit Komunal	x								
Procesverbalet e Komitetit për Politikë dhe Financa	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Planet e Komunës	x	x	x	x	x	x	x	x	x

Edhe pse Ligji për Qasje në Dokumente Publike obligon secilin institucion që të caktojë një përgjegjës për trajtimin e kërkesave zyrtare dhe kontaktin e tij ta bëjë publik në uebfaqen zyrtare të komunës, një gjë të tillë nuk e ka bërë ende Komuna e Kamenicës. Madje kjo komunë ka marrë vërejtje nga MAPL për vonesat në plotësimin e dokumentacionit lidhur me trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike.

## 11. Puna e Kuvendit Komunal të Kamenicës

Kuvendi Komunal i Kamenicës ka 27 anëtarë. PDK ka numrin më të madh të deputetëve, por shumicën votuese në Kuvend e përbën koalicioni LDK-AAK, i mbështetur edhe me votat individuale të deputetëve të AKR dhe LDD, edhe pse formalisht këto dy të fundit nuk janë në koalicion. Grupi më aktiv opozitar është ai i PDK.

Tabela nr.7: Kuvendi Komunal i Kamenicës

Përbërja e Kuvendit Komunal të Kamenicës:	
Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	8
Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)	7
Aleanca Kosova e Re (AKR)	5

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)	5
Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD)	2

Kuvendi Komunal ka mbajtur mbledhjet e rregullta në 2010 dhe 2011, ashtu siç parashihet me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Kryetari i Komunës merr pjesë në të gjitha takimet e Kuvendit Komunal.

Në përgjithësi të gjitha propozim vendimet e Kryetarit të Komunës aprovohen me shumicë votash në KK. Në disa raste Kryetari i Komunës z. Shaip Surdulli përdor gjuhë ofenduese në drejtim të deputetëve të opozitës.

Në prill 2012, anëtarët e KK të Kamenicës janë pajisur me lloptopë. 13.000 euro janë ndarë nga komuna për blerjen e llaptopëve për asambleistët komunal kurse pjesa tjetër është financuar nga USAID.

Të kujdesshëm në shpenzime të parasë publike nuk janë treguar as anëtarët e Kuvendit Komunal. Në gusht të 2010 KK nuk ka mbajtur mbledhje. Në seancën e 30 shtatorit 2011 njëra nga deputetet e LDK ka kërkuar që paratë e mbetura suficit prej 3.000 eurosh nga mos mbajtja e mbledhjes në gusht, të shfrytëzohen për një vizitë në Shqipëri. Kjo ide nuk është kundërshtuar as nga deputetët e opozitës dhe një vizitë e tillë në Shqipëri ka ndodhur në maj të 2011.

## 12. Përmbushja e premtimeve të fushatës zgjedhore 2009

Gjatë fushatës zgjedhore 2009, kandidati për kryetar komune për mandat të tretë, tani kryetari i Komunës z.Shaip Surdulli, elektoratit të tij iu prezantua me një mori premtimesh, të cilat do t'i realizonte nëse do zgjidhej edhe një herë kryetar komune, pas një pauze dy vjeçare.

Pas monitorimit të të gjitha premtimeve të dala nga fushata zgjedhore, Instituti GAP dhe BIRN, në 2010 i kanë shkruar letër

të hapur Kryetarit të Komunës së Kamenicës z.Shaip Surdulli të cilit ia përkujtuan edhe një herë premtimet e dhëna, duke kërkuar njëkohësisht realizueshmërinë e tyre.

Tabela më poshtë mat progresin e arritur në realizueshmërinë e premtimeve të dhëna në 2009. Në këtë tabelë janë përfshirë 20 premtime të dhëna.

Premtimet 2009	Realizimi 2010-2011
Krijimin e Komunës së Hogoshtit	<p>Gjatë fushatës elektorale, në një tubim me simpatizantët e partisë mbajtur në fshatin Hogosht, nënkryetari i LDK z.Lutfi Haziri kishte kërkuar votat e banorëve të këtij lokaliteti duke premtuar se nëse LDK qeveris me Komunën e Kamenicës, Hogoshti do të marr statusin e komunës sërish.</p> <p>Shumë vite para se Kamenica të marr statusin e komunës, Hogoshti ishte komunë. Që nga humbja e statusit të komunës, shumica e fshatrave malore afër Hogoshtit janë zhvendosur në Kamenicë apo komuna tjera, duke bërë që shumë fshatra malore në kufi me Serbinë të mbeten të zbrazëta.</p> <p>Dy vite pas fillimit të mandatit qeverisës, Shaip Surdulli dhe LDK nuk kanë bërë asgjë në drejtim të përmbushjes së premtimit për të bërë Hogoshtin komunë. Banorët e fshatit Hogosht kanë krijuar një fondacion për lobim për të krijuar komunën e re të Hogoshtit, por kjo iniciativë nuk ka marrë mbështetje nga Komuna e Kamenicës, e as që është ngritur për diskutim në Kuvend të Kosovës nga deputetët e LDK. Duhet përmendur se kompetencat për krijimin e komunave të reja i takojnë nivelit qendror, përmes ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për Kufijtë Administrativë Komunal.</p>
Ndërtimin e sistemit të kanalizimit, ujësjellësit dhe meremetimin e shkollës në Hogosht	Nuk është përmbushur asnjëri nga këto tri premtime për fshatin Hogosht.

<p>Vazhdimin e punimeve të filluara në asfaltimin e rrugës Hogosht – Poliçkë – Desivojcë</p>	<p>Asfaltimi i rrugës Hogosht – Poliçkë – Desivojcë ka fillur në 2009 dhe është projekt i financuar dhe i implementuar nga Komisioni Evropian. Ky projekt tanimë ka përfunduar. Komuna e Kamenicës nuk ka qenë e involvuar në këtë projekt dhe premtimi i dhënë nga z.Surdulli ka qenë vetëm për marketing politik.</p>
<p>Asfaltimin e rrugës Hogosht – Kopernicë – lagjja Xhaqkaj si dhe asfaltimin e rrugëve të tjera në këto lokacione</p>	<p>Ashtu sikurse rruga Hogosht – Poliçkë – Desivojcë, edhe asfaltimi i rrugës Hogosht-Kopërnice, nuk ka qenë asnjëherë projekt i Komunës. Asfaltimi i kësaj rruge ka filluar më 2009 dhe projekti është financuar dhe implementuar nga Ministria e Infrastrukturës. Në 2010, Drejtori i Urbanizmit i Komunës së Kamenicës kishte pasur konflikt fizik dhe verbal me punëkryesin kompaninë “Tali”, pasi që ishte ankuar për mënyrën e asfaltimit të rrugës. Kjo rrugë është përfunduar në 2010. Premtimi i z.Surdulli se do të asfaltojë këtë rrugë po ashtu ka qenë një marketing politik.</p> <p>Ajo çfarë ka bërë komuna, është asfaltimi i rrugës në lagjen Xhaqkaj.</p>
<p>Rregullimin e infrastrukturës në fshatin Koretin</p>	<p>Për dy vite Komuna nuk ka bërë asgjë konkrete për të rregulluar infrastrukturën në fshatin më të madh të Komunës, Koretin.</p> <p>Ujësjiellësi i filluar në mandatin e kaluar ende nuk është funksional dhe komuna nuk ka ndërmarrë asgjë që ky projekt të përfundohet si duhet dhe të funksionalizohet. Projekti për renovimin e shkollës fillore në Koretin është shtyrë nga viti në vit dhe ende nuk ka filluar. Përkundër participimit në financim nga banorët, ende komuna nuk ka asfaltuar dy rrugë lokale në Koretin. Një nga problemet më të mëdha me të cilat përballen banorët e këtij lokaliteti është kundërmimi i lumit i cili kalon përmes fshatit. Komuna nuk ka ndërmarrë asgjë në pastrimin e shtratit të lumit apo kanalizimin e ujërave të zeza.</p> <p>Ajo qfarë ka bërë Komuna në “infrastrukturën” e fshatit Koretin është kontributi i dhënë prej 30.000 për ndërtimin e dy xhamive në këtë fshat.</p>
<p>Zhvillimin e ekonomisë bujqësore dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik</p>	<p>Komuna nuk ka bërë asgjë në drejtim të zhvillimit të ekonomisë bujqësore dhe zhvillimit të gjithmbarshëm ekonomik. Drejtorja e Bujqësisë jep subvencione simbolike për bujqit, por kjo nuk ka ndikuar aspak që gjendja në këtë sektor të përmirësohet. Komuna e Kamenicës mbetet një nga komunat më të pazhvilluara ekonomisht.</p>
<p>Krijimin e vendeve të reja të punës</p>	<p>Një nga premtimet më së shumti të përsëritura gjatë fushatave zgjedhore nga të gjithë pretendentët për kryetar komunash është edhe premtimi për krijimin e vendeve të reja të punës. Një premtim i tillë është dhënë edhe nga z.Surdulli. As komuna e Kamenicës por as komunat tjera nuk kanë mundësi ligjore që të</p>

	<p>ndikojnë direkt në krijimin e vendeve të reja të punës. Këtë mund ta bëjnë vetëm në sektorin publik, i cili edhe ashtu është i tejngakruar me staf.</p> <p>Projekti i vetëm i cili ka ndikuar në angazhimin e punonjësve të rinj ka qenë pastrimi i shtratit të lumit në qytet, i cili është financuar nga Banka Botërore dhe janë angazhuar punëkërkuarit e regjistruar në Qendrën e Punësimit, të cilët janë paguar nga 260 euro në muaj.</p> <p>Ky premtim është i porealizuar.</p>
<p>Mbështetjen për bizneset dhe ndërmarrjet e vogla e të mesme, që gjenerojnë punësim dhe të ardhura për familjet</p>	<p>Nuk ka ndonjë ndryshim të politikave komunale kundrejt bizneseve të cilat e ushtrojnë veprimtarinë në këtë komunë.</p> <p>Taksat për biznese kanë mbetur të njëjta. Komuna nuk bën ndonjë dallim në mes bizneseve prodhuese dhe biznese shërbyese. Të gjitha tatimohen, pa ndonjë stimulim nga ana e Komunës. Madje me Rregulloren e re komunale për ngarkesa, tarifa, taksa dhe gjoha komunale, disa bizneseve i janë ngritur taksat, siç është rasti për shembull me ndërmarrjet e materialit ndërtimor (taksa për këtë lloj biznesi është ngritur nga 250 në 300 euro). Në rregulloren e re për taksa janë shtuar edhe 13 biznese, të cilat nuk kanë qenë të parapara me rregulloren e vjetër.</p> <p>Madje taksat për disa lloje të bizneseve janë më të larta se taksat për bizneset e njëjta në Komunën e Gjilanit.</p>
<p>Qeverisje transparente dhe efikase</p>	<p>Qeverisja në Komunën e Kamenicës në vitet 2010-2011 nuk ka qenë as transparente e as efikase. Uebfaqja e komunë nuk përmban dokumentet bazë të Komunës, siç janë rregulloret dhe raportet e Kryetarit dhe drejtorive. Në seancën e 3 të Kuvendit Komunal për 2012 të mbajtur më 30 mars 2012, kryetari i informon delegatët e KK se USAID i ka ndarë komunës 25.000 euro si shpërblim për transparencën e Komunës. Mirëpo po të njëjtën mbledhje Kryetari nuk pranon që t'u ofrojë delegatëve të opozitës informata për bursistët e Komunës, duke u ofruar atyre informatat për notën mesatare dhe emrin e prindit. Po ashtu në të njëjtën mbledhje, një delegat i KK kërkon raport më të detajuar buxhetor për të marrë informata për secilin automjet të Komunës sa ka shpenzuar si dhe informata se cilët individë shfrytëzojnë komunikimin me Vala 900.</p> <p>Përveç jo transparencës, edhe efikasiteti i qeverisjes ka munguar. Në shumë raste tenderët janë anuluar,</p>

	<p>punët janë zvarritur, përderisa shpenzimet e Komunës për dreka zyrtare, karburante, udhëtime, komunikime, janë rritur.</p>
<p>Përmirësimin e kushteve në arsim</p>	<p>Sa i përket infrastrukturës në arsim, Komuna ka bërë disa investime, siç është ndërtimi shkollës në Shipashnicë të Poshtme, instalimi i ngrohjes në shkollën “Fan Noli” në Kamenicë, instalimin e nxemjes në shkollën fillore në Topanicë, trotuarë për skaj shkollës së mesme në Kamenicë, etj. Në përgjithësi për dy vite Komuna ka shpenzuar gjysmë milioni euro për infrastrukturën në arsim.</p> <p>Por problemet në arsimin komunal, përveç infrastrukturës, janë edhe problemet më mësimdhënien, menaxhimin, konkurset në arsim dhe mësimnxënien. Për shumë lëndë mësimore, sidomos për lëndët matematikë, gjuhë angleze, muzikë, fizikë, art, etj., nuk ka kuadro të kualifikuara dhe mësim japin mësimdhënës në pakualifikuar. Po ashtu, Drejtoria e Arsimit është e paaftë në menaxhimin e procesit arsimor. Në dy konkurset e shpallura nga komuna për praninë të personelit arsimor, ka pasur keqpërdorim të konkurseve, pranime në baza familjare dhe partiake, etj.</p>
<p>Rregullimin e infrastrukturës në qytet dhe të gjitha vendbanimet e tjera</p>	<p>Siç mund të shihet nga pjesa 5, Investimet Kapitale, komuna ka investuar në infrastrukturën e qytetit dhe të disa fshatrave. Mirëpo, infrastruktura e Komunës së Kamenicës kërkon investime shumë të mëdha, kurse buxheti i komunës për investime kapitale nuk mund të adresojë të gjithë këto nevoja. Komuna nuk ka një dokument unik i cili i identifikon të gjitha investimet e nevojshme në infrastrukturë, në të gjitha vendbanimet.</p> <p>Andaj, rregullimi i infrastrukturës në vendbanimet e Kamenicës nuk mund të konsiderohet si proces i përmbyllur.</p>
<p>Mbështetjen e rasteve sociale</p>	<p>Me ndryshimin e Ligjit për Skemën e Ndhmës Sociale dhe me bartjen e kompetencave nga niveli qendror në të lokal, ndihmat sociale tani menaxhohen nga komunat.</p> <p>Në disa raste, Kuvendi Komunal me propozim të kryetarit të Komunës ka marrë vendim për të ndihmuar familjet në gjendje të rëndë sociale; për të ndarë tokë shoqërore për ndërtim të shtëpive për raste sociale, etj. Po ashtu Komuna ka përcaktuar lokacionin për ndërtimin e një ndërtese kolektive për rastet sociale. Megjithatë, ende mbeten shumë raste të rënda sociale, të cilat komuna nuk mund t'i përgjigjet.</p>
<p>Përkrahjen e klubeve</p>	<p>Në Komunën e Kamenicës janë aktive disa klube sportive, si: Klubi i Atletikës “Rogana”, Klubi i Futbollit</p>

<p>sportive ekzistuese dhe stimulimin e krijimit të klubeve të reja</p>	<p>“Kaolini”, Klubi i Futbollit “Kamenica”, Klubi i Karatesë “Arbëria”, Klubi i Volejbollit “Arbëria”, Klubi i Volejbollit “Flaka”, Klubi i Atletikës “Arbëria”, Klubi i Shahut “Dardana”, Klubi i Shenjtarisë “Dardana”.</p> <p>Nga këto, më i suksesshmi është Klubi i Atletikës “Rogana”. Atletët e këtij klubi dhe trajneri janë shpallur sportistët më të mirë të vitit në Komunën e Kamenicës. Po ashtu, atletët nga ky klub. Astrit Kryeziu dhe Musa Hajdari, janë rekordmen kombëtar në disiplinat e vrapimit 100m, 200m, 400m, 800m, 1500m. Astrit Kryeziu është edhe fitues i mitingut ndërkombëtar të atletikës 2011 në Mal të Zi.</p> <p>Nuk ekziston ndonjë mbështetje sistematike për klubet, madje edhe për ato më të suksesshmet, siq është KA “Rogana”. Mbështetja financiare e komunës zakonisht bëhet për të gjitha këto ekipe sportive, duke i ndrë mjete herë pas here për pagesë të referove, shpenzimet e karburanteve të udhëtimit dhe kuotizimi. Në vitin 2011 Komuna i ka ndarë 11.720 euro për këto ekipe të lartëpërmendura. Kjo shumë është shuma e njejtë sa ka shpenzuar në 2010 për dreka zyrtare Zyra e Kryetarit.</p>
<p>Investimet në lagjen Malësia</p>	<p>Komuna e Kamenicës ka investuar rreth 50.000 euro në ujësjellës në lagjen “Malësia” dhe tani për tani problemi me ujë në këtë lagje konsiderohet i zgjidhur.</p>
<p>Riasfaltimin e rrugës dhe rregullimin e trotuarit në lagjen Çamëri</p>	<p>Në lagjen “Camëria” nuk është shtruar rruga dhe trotuari.</p>
<p>Ndërtimin e urës dhe rrugës që lidh lagjen Çamëria me lagjen Malësia, që do të kushtojë rreth 220.000 euro</p>	<p>Komuna ka ndërtuar një urë mbi lumin e cila lidh lagjen “Cameria” me shkollën fillore në lagjen “Malësia”. Pas ndërtimit të shkollës fillore është parë e domosdoshme ndërtimi i kësaj ure. Prindërit e fëmijëve të cilët banojnë në lagjen “Camëria” kishin refuzuar dërgimin e fëmijëve në shkollën e re nëse nuk ndërtohet ura.</p> <p>Ura e ndërtuar është urë montazhë. Komuna nuk i ka shpenzuar 220.000 për ndërtimin e urës, ashtu siq ka qenë premtimi i kryetarit. Mjetet për ndërtimin e kësaj ure janë ridestinuuar në projekte tjera. Por, problemi për nxënësit e lagjes “Cameria” është zgjidhur dhe ata mund të përdorin këtë urë për të shkuar në shkollë.</p>
<p>Përfundimin e palestrës sportive në vitin e parë të mandatit</p>	<p>Palestra sportive në qytetin e Kamenicës ka filluar së ndërtuari qysh më 2004. Ndërtimi i këtij objekti është përcjellur me parregullsi të shumta, të cilat janë identifikuar edhe nga Auditori i Përgjithshëm. Përkundër premtimeve, problemi i palestrës së sporteve, i cili nuk është ndërtuar për shumë vite, nuk</p>



	<p>është zgjidhur as në mandatin e PDK e s në atë të LDK.</p> <p>Përkundër premtimit të z.Surdulli se do të përfundoj palestrën sportive që në vitin e parë qeverisës (2012) një gjë e tillë nuk ka ndodhur ende. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MKRS) më 14 shtator 2011 ka kontraktuar një kompani të re për vazhdimin e punimeve në palestrën e sporteve. Punimet në këtë objekt vështirë të përfundojnë deri në 2013, nëse ecet me dinamikën aktuale të punëve.</p>
Rishqyrtimin e të gjitha vendeve të punës, me qëllim të rregullimit të çështjes së administratës komunale	<p>Me marrjen e mandatit të Kryetarit, z.Surdulli kishte larguar 48 punonjës të cilët ishin angazhuar pa kontratë, me kontratë mbi vepër, por edhe me kontrata të rregullta. Menjëhërë pas kësaj ai kishte shpallur konkurs për pranimin e 33 punëtorëve të rinj. Të gjitha pranimet ishin bërë në baz partiake.</p> <p>Komuna e Kamenicës është e mbingarkuar me staf. Edhe pse territori i Komunës është tkurrur dhe numri i popullsisë ka rënë, numri i të punësuarve në administratë është ngritur në 222.</p> <p>Administrata nuk është efikase dhe kushtet për punë nuk janë të mira. Komisioni Evropian ka financuar ndërtimin e një objekti të ri të Komunës dhe ky investim pritet të përmirësoj kushtet për punë. Mirëpo me dinamikën e tanishme të punëve, objekti i administratës nuk pritet të finalizohet deri në fillim të 2014.</p>
Kryerjen e projekteve të filluara si: ujësjellësi në qytet, në Koretin, në Shipashnicë të Epërme dhe në Kopërnice	<p>Përderisa është finalizuar puna në ujësjellësin në Kopërnice dhe Shipashnicë të Epërme, problem mbetet ujësjellësi në fshatin Koretin.</p> <p>Ujësjellësi në fshatin Koretin, i filluar që në 2008, ende nuk është përmbyllur në tërësi. Banorët e Koretin janë lidhur secili individualisht në rrjet, duke bërë që uji i lëshuar gjatë verës dhe dimrit 2011 të keqpërdoret. Si pasojë e mos kontrollit nga ana e Komunës, banorët nuk i kanë paguar shpenzimet e rrymës së ujësjellësit. Në mungesë të mbështetjes së Komunës, banorët janë vetëoraginzuar për të mbledhur mjetet për pagesën e borxhit ndaj KEK-ut si dhe vendosjen e njësorëve për matjen e shpenzimeve të ujit. Por ende ky ujësjellës nuk është funksional.</p>
Ndërtimin e një shkolle të re të mesme në Roganë.	<p>Premtim i pa realizuar. Shkolla e mesme në Roganë zhvillon mësimet në objektin e shkollës fillore dhe në këtë shkollë mësimi zhvillohet në tri ndërrime.</p>

## Burimet:

1. Kuvendi Komunal i Kamenicës. Procesverbalet e mbledhjeve të Kuvendit Komunal për 2010, 2011 dhe janar-mars 2012. Procesverbalet e KK të Kamenicës janë të publikuara edhe në uebfaqen e Komunës (me përjashtim të atyre të 2010): [http://kk.rks.gov.net/kamenice/Municipality/Assembly/Procesverbalet-\(1\)/Viti-2011.aspx](http://kk.rks.gov.net/kamenice/Municipality/Assembly/Procesverbalet-(1)/Viti-2011.aspx)
2. Kuvendi Komunal i Kamenicës. Raporti i punës së KK janar-dhjetor 2011. Dhjetor 2011. Burimi: <http://kk.rks.gov.net/kamenice/getattachment/Municipality/Assembly/Reports/Raport-i-Punes-Janar-Dhjetor-2011-i-Kuvendit-Komunal.pdf.aspx>
3. Zyra e Prokurorit të Komunës së Kamenicës. Raporti Vjetor për Kontratat e Nënshkruara Publike gjatë vitit fiskal 2010 me vlerë minimale, të vogël, të mesme dhe të mëdha. 25 janar 2011.
4. Zyra e Prokurorit të Komunës së Kamenicës. Raporti Vjetor për Kontratat e Nënshkruara Publike gjatë vitit fiskal 2011 me vlerë minimale, të vogël, të mesme dhe të mëdha. 13 janar 2012.
5. Instituti GAP dhe BIRN. Letër e Hapur Kryetarit të Komunës së Kamenicës z.Shaip Surdulli. Burimi: <http://institutigap.org/repository/docs/LeterKamenic.pdf>
6. Raportet vjetore të punës së Zyrës së Kryetarit dhe raportet individuale të drejtorive për vitin 2011.
7. Raporti Financiar i Komunës së Kamenicës për vitin 2011.
8. Raporti Financiar i Komunës së Kamenicës për periudhën janar-dhjetor 2012.
9. Zyra e Auditorit Gjeneral. Raporti i Auditorit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare për fund vitin 31 dhjetor 2011. Burimi: [http://www.oag-rks.org/repository/docs/AuditOpinion\\_Kamenica\\_2010\\_Alb\\_592366.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/AuditOpinion_Kamenica_2010_Alb_592366.pdf)